

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDACIONI “LOGOS”
KOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”

Rruga “Dritan Hoxha”, Pallatet “Komfort”, Tel: ++355 4 240 5355, Cel: ++355693030277

email: [info@Kolegji_Universitar “LOGOS”ogos.edu.al](mailto:info@Kolegji_Universitar_“LOGOS”ogos.edu.al)



Raport vjetor
për
Veprimtarinë e Kolegjit Universitar “LOGOS”
për Vitin Akademik
2023-2024

(Informacioni i mbuluar nga Bordi i Administrimit është për periudhën kalendarike Janar –
Dhjetor 2024)

DHJETOR 2024

Miraturar me:

Vendimin Nr. 8, dt.16.12.2024 të Rektoratit

Vendimin Nr.27, dt.18.12.2024 të Senatit Akademik

Vendimin Nr.6, dt.18.12.2024 të Bordit të Administrimit

PASQYRA E LËNDËS

I.	HYRJE	3
II.	PËRMBLEDHJE E RAPORTIT	4
A.	SENATI AKADEMIK.....	9
a)	INFORMACION MBI REALIZIMIN E QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE TË MËSIMDHËNIES, TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE VEPRIMTARIVE KRIJUESE DHE INOVACIONIT.....	9
b)	INFORMACION PËR BASHKËPUNIME NDËRINSTITUCIONALE DHE PROJEKTE KU MERR PJESË KOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”	12
c)	INFORMACION PËR KËRKIMIN SHKENCOR	26
	Politika e kërkimit shkencor	26
	Informacion për lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien.....	28
	Produktet në fushën e kërkimit shkencor dhe të zhvillimit.....	29
	Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor.....	34
d)	INFORMACION PËR PROGRAMET E STUDIMIT QË OFRON KOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”	35
e)	NDRYSHIMET NË BAZËN RREGULLATORE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “LOGOS”	45
	INFORMACION PËR VEPRIMTARINË E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË	47
f)	INFORMACION PËR ANGAZHIMIN E PERSONELIT AKADEMIK.....	48
g)	TË DHËNA PËR GJURMIMIN E STUDENTVE QË KANË PËRFUNDUAR STUDIMET PËR SECILIN PROGRAM STUDIMI.....	57
h)	TË DHËNAT PËR KËSHILLAT STUDENTORË DHE PËRFAQËSIMI I TYRE NË ORGANET DREJTUESE DHE NË NJËSINË E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË	60
i)	VLERËSIMET DHE REKOMANDIME TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “LOGOS” PËR MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË.....	62
j)	INFORMACION PËR STUDENTËT.....	62
	ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV	69
	Biblioteka e Kolegjit Universitar “LOGOS”	82
	Pasurimi i Bibliotekës së Kolegjit Universitar “LOGOS” (2024).....	83

I. HYRJE

Kolegji Universitar “LOGOS” ka zanafillën e tij që prej vitit 2000 me krijimin dhe funksionimin e Institutit të Formimit Profesional 2-vjeçar “*Frymë Dashurie*” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 350, datë 16.11.2000 “Për dhënie leje funksionimi të Institucionit Arsimor Plotësues Jopublik”. Gjatë 10 viteve të veprimtarisë së tij, Instituti “Frymë Dashurie” u angazhua në përgatitjen e specialistëve në *Llogari të Kompjuterizuar, Informatikë, Kuadër Menaxher* si dhe *Laborant Mjekësor*, duke u mbështetur e reflektuar në ofertën e tij formuese kërkesat e nevojat e tregut të punës për këto programe profesionale në Shqipëri.

Kolegji Universitar “LOGOS” u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1055 datë 29.07.2009 për të ushtruar veprimtarinë e tij në qytetin e Tiranës dhe organizimin e tij fillimisht me dy fakultete; Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, dhe Fakultetin Ekonomik. Në vijim, me Urdhër të Ministrit Nr. 396 datë 01.08.2010, Ministria e Arsimit dhe Shkencës miratoi lejimin e ushtrimit të veprimtarisë akademike për dy programey e ciklit të parë të studimit: *Informatike e Zbatuar* dhe *Menaxhim-Turizmi*.

Kolegji Universitar “LOGOS” funksionon nën mbështetjen financiare të vazhdueshme të Fondacionit “LOGOS”, themeluar nga Kryepeshkopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Fortlumluria e Tij, Prof. Dr. Anastasios Yannoulatos. Kryepeshkopi Anastasios Yannoulatos është erudit i njohur, i cili ka shërbyer si Profesor i Historisë së Shkencave Fetare në Universitetin Shtetëror të Athinës, Kapodistria nga viti 1972 - 1992, që edhe sot e kësaj dite mban titullin Profesor Emeritus. Gjithashtu, ai është edhe Anëtar Nderi në Akademinë e Athinës, Senator Nderi në Akademinë Europiane të Shkencës dhe Artit në Salsburg që prej vitit 2019. Ai ka marrë titullin Doktor Nderi në Teologji dhe Filozofi nga njëzet universitete, shkolla universitare dhe departamente (nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës deri në Evropë nga Italia, Greqia, Rumania, e disa shtete të tjera).

Kolegji Universitar “LOGOS” prej orientimit të motos shoqëruese të tij “*DRITË DHE FUQI JETE*” përmbledh kuptimin dhe qëllimin e krijimit dinamik akademik me këndvështrim të hapur. Prej këtij orientimi, Kolegji Universitar “LOGOS” mbështetur në vizionin e Fondacionit nëpërmjet

organeve të tij drejtuese është përkushtuar të pajisë studentët me këndvështrimin individual dhe profesional, me veprimtari ekstrakurrikulare, praktika pune, lëvizshmëri dhe ndërmjetësim karriere.

Kolegji Universitar “LOGOS” ka në strukturën e tij 3 (tre) fakultete (Fakultetin Ekonomik, Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Fakultetin e Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor) dhe 9 (nëntë) departamente. Drejtimit akademike e të programeve të studimit janë ato të Shkencave Mjekësore Teknike, Teknologjisë së Informacionit, Shkencave Ekonomike e Menaxhimit, Shkencave Humane e Gjuhësore dhe të Edukimit. Kolegji Universitar “LOGOS” në vitin akademik 2023-2024 ka ofruar 16 programe studimi (Tabela Nr. 8) të akredituara dhe në proces akreditimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

II. PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Raporti vjetor i Kolegjit Universitar “LOGOS” (KU “LOGOS”) për vitin akademik 2023-2024 është përgatitur nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit i institucionit dhe është strukturuar sipas çështjeve të kërkuara, fushave dhe kompetencës.

Raporti vjetor paraqet informacion transparent dhe simetrik për veprimtarinë e Kolegjit Universitar “LOGOS” në zbatim të misionit të tij dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi me qëllim realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese. Gjithashtu, ky raport paraqet informacion mbi gjendjen financiare të KU “LOGOS”, tarifat e shkollimit për vitin 2023-2024, për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi, si dhe elemente të tjera që lidhen me shërbimet që KU “LOGOS” ofron. Shkrimi i këtij raporti nxit dhe rrit përgjegjshmërinë, transparencën dhe sigurinë e cilësisë së veprimtarisë së KU “LOGOS”, si edhe paraqet problemet e konstatuara gjatë vitit akademik 2023-2024, me qëllim zgjidhjen e tyre, në bashkëpunim me strukturat shtetërore në fushën e arsimit.

Referuar dhe bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e Kolegjit Universitar

“LOGOS”, Rregulloren e Kolegjit Universitar “LOGOS”, e ndryshuar, Planin e zhvillimit strategjik të Kolegjit Universitar “LOGOS”, si dhe në Udhëzimin nr. 5, datë 19.02.2018, të ministrit të Arsimit dhe Sportit (MAS) “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor...”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.24, datë 21.10.2019, Kolegji Universitar “LOGOS” paraqet Raportin vjetor të veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore për vitin akademik 2023-2024 dhe financiar për vitin (kalendarik) 2024 në nivel kolegji universitar, në kuadër të informimit dhe transparencës për veprimtarinë e tij ndaj gjithë pretendentëve.

Kolegji Universitar “LOGOS” ofron programe në dy ciklet e studimit, në përputhje me standardet me të larta akademike dhe profesionale, në përgatitjen e profesionistëve në fushën e ekonomisë, menaxhimit, financës dhe kontabilitetit, në informatikë të aplikuar, në përgatitjen e teknikëve të laboratorëve mjekësorë, në studime teologjike dhe fetare, në gjuhësi, arsim parashkollor, punë sociale, në agrobiznes, etj. Kolegji Universitar “LOGOS” synon të plotësojë nevojat e arsimit të lartë dhe të ekonomisë shqiptare duke ofruar arsimim gjithëpërfshirës të studentëve, kualifikimin e tyre, kërkimin shkencor të stafit akademik dhe veprimtarive të tjera.

Ky raport në zbatim të misionit të Kolegjit Universitar “LOGOS” dhe kuadrit ligjor në fuqi synon të paraqesë aspektet kryesore të aktivitetit akademik të tij, duke vënë theksin edhe në problematika të evidentuara dhe të adresuara për zgjidhje, me qëllim rritjen e mëtejshme të cilësisë.

Raporti vjetor i Kolegjit Universitar “LOGOS” bazohet në raportet analitike të njësive kryesore (fakultetet) të KU “LOGOS”, si dhe të strukturave të tjera, përfshirë ato administrative të Kolegjit Universitar “LOGOS”. Disa prej tyre janë radhitur si më poshtë:

- Raportin vjetor për veprimtarinë e fakultetit për vitin akademik 2023-2024 të Fakultetit Ekonomik.
- Raportin vjetor për veprimtarinë e fakultetit për vitin akademik 2023-2024 të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara.
- Raportin vjetor për veprimtarinë e fakultetit për vitin akademik 2023-2024 të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor.
- Raporte informuese e analitike të organeve kolegjiale të Kolegjit UNIVERSITAR “LOGOS” (Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit).

- Raporte informuese e analitike të komisioneve në nivel universiteti (Këshilli i Etikës, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë).
- Të dhënat statistikore të marra nga Administratori, Financa, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Marrëdhënieve me Studentët, Biblioteka, Sekretaria, etj.
- Materiale, dokumente dhe informacione, të hartuara në kuadër të veprimtarive të ushtruara në nivel institucional, njësie kryesore, njësie bazë apo të zhvilluara nga personeli akademik i Kolegjit Universitar “LOGOS”.

Raporti vjetor për vitin akademik 2023-2024 i Kolegjit Universitar “LOGOS” përmban informacion të përmbledhur për veprimtarinë në tërësi të Kolegjit Universitar “LOGOS” në përmbushje të misionit të tij, duke u përqendruar në arritjet, sfidat dhe rrugëzgjdhjet për to si dhe në synimet për të ardhmen sipas strukturës së informacionit të kërkuar në udhëzimin përkatës të MAS si edhe mendime dhe rekomandime për bashkëpunimin e mëtejshëm me MAS. Ndërsa aktivitetet e detajuara në nivel njësie kryesore janë publikuar në faqet zyrtare të KU “LOGOS”.

Arritje

Aktiviteti i Kolegjit Universitar LOGOS, gjatë vitit akademik 2023-2024 është realizuar në përputhje me *Planin Strategjik të Zhvillimit për periudhën 2018-2024* dhe janë shënuar këto arritje:

1. Në aspektin e zhvillimit institucional

- Në vitin akademik 2023-2024 Kolegji Universitar “LOGOS” ka investuar akoma më shumë në zhvillimin e strukturave të duhura të qeverisjes dhe kapacitetin e menaxhimit për të mbështetur një popullatë të qëndrueshme të numrit të studentëve;
- Në vëmendje për zhvillimin institucional ka qenë aftësimi i studentëve për punë e sipërmarrje duke ju mundësuar studentëve aplikimin e njohurive teoriko shkencore të marra përmes laboratorëve në ambjentet e KU “LOGOS”, përmes krijimit të qendrës për sipërmarrësit e rinj dhe edukim digjital në kuadër të projekteve të financuara nga BE dhe Fonadcioni LOGOS, si edhe nëpërmjet praktikave pranë subjekteve me të cilat KU “LOGOS” ka bashkëpunim dhe partneritet;
- U përmbyllë me sukses procesi kontrollit të pajtueshmërisë së veprimtarisë së KU “LOGOS” me aktet ligjore e nenligjore në fuqi.

- U përmbyllën me sukses disa akreditime programesh studimi dhe jemi në pritje për marrjen e vendimeve nga bordi i akreditimit të ASCAL;
- U shënuan arritje në ndryshimin e imazhit të institucionit nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me shkollat e mesme, zgjerimit të partneritetit me institucione dhe organizata të ndryshme, zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, mediatik, etj;
- U punua për draftimin e raporteve të vlerësimit të brendshëm për disa programe studimi të afëruara nga KU “LOGOS”;
- Etj.

2. Në aspektin e zhvillimeve akademike

- U zbatua qasja “studenti në qendër” të mësimdhënies dhe të gjithë veprimtarisë së institucionit.
- U përmirësua cilësia e personelit akademik me rekrutimin e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm me tituj e grada, me përvoja akademike dhe ekspertizë në fushë dhe personalitete të sipkatura.
- Kolegji Universitar “LOGOS” përgjatë vitit akademik 2023-2024 mori miratimin final për hapjen për herë të parë pranë Fakultetit Ekonomik të një programi studimi Master Shkencor “Financë Kontabilitet” (i miratuar nga MAS dhe i cili u hap në vitin akademik 2024-2025 për studentët). Kolegji Universitar “LOGOS” gjatë gjithë veprimtarisë së tij ka synuar të ofroj programe studimi në përputhje me tendencat e ndërkombëtare por duke ruajtur dhe konsoliduar më shumë në edukimin e brezave të cilët do mund të kontribuojnë në prosperitetin e Shqipërisë.
- U realizuan studime dhe analiza për hapjen e programeve të reja të studimit nga disa prej departamenteve në KU “LOGOS”;
- U zhvilluan leksione të hapura dhe trajnime me personelin akademik duke u mbështetur edhe përmes krijimit të Qendrës për Mësimdhënie dhe të Nxënies në KU “LOGOS”.
- Pavarësisht se kanë kaluar disa vite nga Covid 19, Kolegji Universitar “LOGOS” vijon ta mbajë aktive platformën TEAMS duke ju përshtatur ndryshimeve të teknologjisë mësimore në shërbim të studentëve dhe pedagogëve, në përgjigje të ndryshimeve të të nxënies nga studentët për t’ju përcjellë materiale mësimore dhe komunikim të vazhdueshëm online sipas çdo lënde nga pedagogët dhe studentët.

3. Në aspektin e kërkimit dhe zhvillimit

- Pedagogët kanë marrë pjesë individualisht në konferenca shkencore të organizuara brenda dhe jashtë vendit.
- Janë mbështetë stafi akademik ekzistues për vijimin e procesit të kërkimit shkencor dhe publikimit të punimeve me qëllim marrjen e gradave shkencore dhe titujve akademik.
- Ka aplikuar në disa projekte të financuara nga BE dhe ka arritë edhe të jetë fitues.

4. Në aspektin e sigurimit të cilësisë

- U aplikua politika e sigurimit të cilësisë e Kolegjit Universitar “LOGOS”.
- U kryen vlerësimet periodike për pedagogët dhe personelin akademik.
- U kryen vlerësimet periodike nga studentët për mësimdhënien dhe veprimtarinë e departamenteve.

Sfida

Gjatë vitit akademik 2023-2024, Kolegji Universitar “LOGOS” ndeshi disa sfida:

- Sfida për kthimin e vëmendjes së studentëve drejt shkencës duke pasë nga ana tjetër sfidat që kanë të rinjtë e kësaj gjenerate në menaxhimin e kohës dhe objektivave të tyre. Kjo është një sfidë e cila çdo vit kërkon vëmendje duke qënë se jemi në një industri e cila ndryshon vazhdimisht për t’ju përshtatur zhvillimeve globale.
- Sfida për rekrutimin e studentëve dhe pedagogëve të rinj.
- Sfida e përshtatjes dhe të zhvillimit të teknologjisë digitale për procesin mësimor.

Synime për vitin akademik 2024-2025

1. Realizimi i objektivave të përcaktuara në Planin Strategjik të Zhvillimit.
2. Pasurimi i portofolit të dokumenteve të politikave dhe dokumenteve rregullatore për të mbështetur një organizim dhe qeverisje më efektive të institucionit në funksion të ambicieve të tij për ruajtjen e një rritje të qëndrueshme të numrit të studentëve të regjistruar.
3. Pasurimi i ofertës akademike me programe të reja studimi bazuar në zhvillimet në vend dhe për ndërkombëtarizim.
4. Ruajtja e praktikave të mira i metodologjisë së mësimdhënies në distancë.

5. Zgjerimi i partneriteteve për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënit, kërkimin dhe punësimin e studentëve duke krijuar forumet dhe mekanizmat përkatës.
6. Nxitja dhe motivimi stafit akademik për të vijuar me kërkim dhe publikim të punimeve të tyre shkencore.

A. SENATI AKADEMIK

a) INFORMACION MBI REALIZIMIN E QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE TË MËSIMDHËNIES, TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE VEPRIMTARIVE KRIJUESE DHE INOVACIONIT

Kolegji Universitar “LOGOS” mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 6/201¹, ka hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit 2018-2024 dhe veprimtarinë e tij e ka zhvilluar bazuar në këtë plan strategjik të zhvillimit afatmesëm.

Misioni i Kolegjit Universitar “LOGOS” është: t’i shërbejë shoqërisë nëpërmjet arsimimit, kërkimit shkencor, inovacioneve; nxitjes së zhvillimit individual për transformimin e jetëve; garantimit të suksesit të studentëve në një mjedis global; ofrimit të shërbimeve akademike dhe zhvillimit të një komuniteti të larmishëm dhe gjithëpërfshirës.

Gjatë vitit akademik 2023-2024, Kolegji Universitar “LOGOS” nëpërmjet organeve kolegjiiale dhe strukturave përgjegjëse ka punuar frontalisht në të gjitha fushat për realizimin e prioriteteve të përcaktuar në planin strategjik të zhvillimit:

Prioriteti strategjik 1: Zhvillimi institucional

- Konsolidimi i departamenteve të riorganizuara, departamenteve të reja.
- Përgatitja e dokumenteve të politikave për mësimin në distancë

¹ Ligji 80/2015; Neni 6/20; “Plani strategjik i zhvillimit të institucionit” është dokumenti ku përcaktohen objektivat e institucionit të arsimit të lartë apo të njësive përbërëse të tij, si dhe mjetet e mënyrat e realizimit të tyre”

- Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit rregullator në përshtatje me kushtet e mësimin në distancë
- Trajtimi i studentëve si partnerë aktivë në arsimimin e tyre për kapërcimin e vështirësive të mësimin në distancë.
- Përgatitja e paketës për të marrë vlerësimin e studentëve për procesin mësimor në Kolegjin Universitar “LOGOS”, pavarësisht formës së mësimdhënies

Prioriteti strategjik 2: Përmirësimi i vazhdueshme i kurriKolegji Universitar “LOGOS”ës

- Përmirësimi i vazhdueshme i kurriKolegji Universitar “LOGOS”ës
- Hapja e programeve të reja të studimit
- Diversifikimi në teknikat e mësimdhënies dhe të nxënies

Prioriteti strategjik 3: Kërkimi

- Lidhja e kërkimit me mësimdhënien
- Përgatitja e portofolit të kërkimit të institucionit

Prioriteti strategjik 4: Zhvillimi i partneritetit

- Zgjerimi i partneriteteve për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënies, kërkimin dhe punësimin e studentëve

Prioriteti strategjik 5: Ndërkombëtarizimi

- Të zhvillohet lëvizshmëria e studentëve dhe shkëmbimeve të stafit

Prioriteti strategjik 6: Sigurimi i cilësisë

- Të gjitha standardet e cilësisë duhet të përmbushen përmes proceseve të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit
- Të përmirësohet funksionimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë
- Publikimi dhe zbatimi i politikës dhe i rregullores për sigurimin e brendshëm të cilësisë
- Realizimi i vlerësimit të brendshëm

Misioni i Kolegji Universitar “LOGOS” është konceptuar në përputhje me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, të paraqitur në nenin 1 të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me karakteristikat specifike që mbart dhe vlerën e shtuar që synon të sjellë Kolegji Universitar “LOGOS” në fushën e arsimit të lartë si dhe me misionin e arsimit të lartë në sheKolegji Universitar “LOGOS”lin e 21-të.

Në përmbushje të këtij misioni, Kolegji Universitar “LOGOS” kreu këto veprimtari gjatë vitit akademik 2023-2024:

- a. Ofroi arsimim për të gjithë studentët që zgjodhën programet e studimit të ciklit të parë, tre programet e studimit të ciklit të dytë, si dhe programin professional 2-vjeçar.
- b. Punoi për të aplikuar ofertën akademike me programe te reja studimi dhe për të përmirësuar kurrikulat e programeve ekzistuese të studimit.
- c. Mësimdhënia u integrua më mirë me kërkimin duke përdorur qasjet:
 - *mësimdhënia e udhëhequr nga kërkimi;*
 - *mësimdhënia e orientuar drejt kërkimit;*
 - *mësimdhënia e bazuar në mentorimin kërkimor;*
- d. Kolegji Universitar “LOGOS” ka organizuar konferenca, tryeza të rrumbullakta, leksione të hapura, etj. Pedagogët realizuan kërkime dhe botime individuale.
- e. U zbatua qasja “studenti në qendër” të veprimtarisë mësimore dhe të veprimtarive të tjera të institucionit që ndikoi në aktivizimin më të madh të studentëve dhe në nxitjen e zhvillimit individual të tyre gjë që mundësoi përballimin e sfidës së mësimin në distancë dhe transformimit të jetëve që është edhe pjesë e misionit të Kolegji Universitar “LOGOS”.
- f. Lidhur me ofrimin e shërbimeve akademike, anëtarët e komunitetit të Kolegjit Universitar “LOGOS” kanë kryer veprimtari që lidhen me shërbime ndaj institucionit, si pjesëmarrja në organet drejtuese, kryerja e punës mbështetëse administrative, shërbimi në grupe pune për çështje me të cilat është përballur komuniteti i kolegjit, veprimtari të drejtimit të fakulteteve, kontributi për mbështetjen e veprimtarisë së studentëve; angazhimi si ekspertë në çështje jashtë kolegjit, shërbim për agjencitë qeveritare; pjesëmarrja në përpjekjet bashkëpunuese me shkollat, agjencitë; shërbime për komunitetin, si vizita informuese në shkollat e mesme të

vendit, mundësi që studentët të provojnë përvojat profesionale në kampus, në organizata të llojeve të ndryshme jashtë institucionit.

- g. Aktivitet e kryera nga stafi akademik i “LOGOS” kanë qenë në përputhje me marrëveshjet e lidhura që në fillim të vitit akademik.

b) INFORMACION PËR BASHKËPUNIME NDËRINSTITUCIONALE DHE PROJEKTE KU MERR PJESË KOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”

Bashkëpunimi dhe ndërtimi i partneriteteve me organizata jashtë institucionit është jetësor për arritjen e vizionit dhe përmbushjen e misionit të Kolegji Universitar “LOGOS”. Kolegji Universitar “LOGOS” ka bashkëpunime me institucione dhe organizata të llojeve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si me institucione të arsimit të lartë, me institucione shtetërore, me institucione të pavarura, me institucione shëndetësore, me organizata profesionale, me organizata të biznesit dhe të shërbimit. Këto bashkëpunime dhe partneritete mundësojnë përvoja praktike për studentët, shkëmbim të personelit dhe të studentëve; ofrojnë mundësi punësimi për të diplomuarit; mundësojnë veprimtari të përbashkëta kërkimore, trajnime, dhënie konsulence dhe ekspertize. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve Kolegji Universitar “LOGOS” përcjell përvojën e vet më të mirë tek partnerët dhe jep kontribut në zhvillimin e shoqërisë.

Në kuadrin e Planit Strategjik të Zhvillimit 2018-2024, Kolegji Universitar “LOGOS” ka përcaktuar disa objektiva në fushën e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar që synojnë shtimin dhe zgjerimin e partneriteteve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të mbështetur mësimdhënien, të nxënës, kërkimin, punësimin e studentëve dhe shkëmbimin e përvojave.

Në përmbushje të misionit të tij, Kolegji Universitar “LOGOS” ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si me institucione të arsimit të lartë, biznese të vogla, të mesme apo të mëdha, shkolla të mesme profesionale apo të përgjithshme, etj. (shih të dhënat në tabelat 2,3,4,5,6)

Bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit

Bashkëpunimi i Kolegjit Universitar “LOGOS” me IAL brenda dhe jashtë vendit mundëson shkëmbimin e eksperiencave mësimore dhe shkencore mes stafit akademik dhe studentëve, përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe angazhimin në projekte të përbashkëta. Përgjatë vitit akademik 2023-2024 niveli i bashkëpunimit me institucionet jashtë vendit pati një ecuri të mirë krahasuar me vitet e kaluara akademike por edhe duke konsideruar kushëtzimet dhe shtrëngimet e burimeve financiare për shkak të krizës dhe prioriteteteve të ndërmarra lidhur me angazhimet e konflikteve në vende të Evropës lindore.

Bashkëpunimi midis palëve është përqendruar në këto drejtime kryesore:

- Bashkëpunim akademik në fushat e mësimdhënies dhe të kërkimit, si dhe në fusha të tjera me interes të ndërsjelltë.
- Shkëmbime dhe pjesëmarrje në eksperiencë mësimore të stafit akademik dhe në fushën e kërkimit shkencor.
- Pjesëmarrje të studentëve në programin Erasmus+ për të përfutur nga mundësitë e ofruara nga angazhimi i Shqipërisë në programin Erasmus+ për lëvizshmërinë e studentëve.(shih tabelën 3)
- Pjesëmarrje të pedagogëve në programin Erasmus+ për të përfutur nga mundësitë e ofruara nga angazhimi i Shqipërisë në programin Erasmus+ për lëvizshmërinë e pedagogëve. (shih tabelën 3)
- Pjesëmarrja në projekte të përbashkëta, konferenca dhe aktivitete të tjera akademike me rëndësi për të dy palët.
- Shkëmbime të informacionit akademik, mësimor dhe kërkimor.

Marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera

Për realizimin e misionit të tij, Kolegji Universitar “LOGOS” ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh ku studentët kryejnë praktikën, shkëmbejnë eksperiencat dhe fitojnë aftësi profesionale. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit është aftësimi profesional i studentëve, kryerja e praktikave profesionale, mundësia për trajnime dhe internshipe, mbështetja për kryerjen e temave të diplomave si dhe mundësia që u jepet studentëve më të mirë për t’u punësuar në këto institucione.

Gjatë vitit 2023-2024 u vijua bashkëpunimi dhe konsolidimi i marrëdhënieve të krijuara përmes marrëveshjeve të bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë, vendas dhe të huaja, si edhe u lidhën marrëveshje të reja me disa IAL por edhe institucione të tjera të rëndësishme për veprimtarinë akademike, mësimore dhe aplikative të KU “LOGOS” (shih tabelën 2 dhe 3).

Në kuadrin e Programit Evropian ERASMUS+, gjatë vitit akademik 2023-2024, Kolegji Universitar “LOGOS” ka realizuar mobilitete individuale të personelit akademik dhe administrativ dhe ka pritur mobilitete nga universitetet evropiane.

Për tu veçuar për vit akademik 2023-2024 është zgjerimi akoma edhe më i madh i përfshirjes së Kolegjit Universitar LOGOS si partner në disa projekte të financuara nga BE, ku përveç atyre ekzistues të tilla si: OASIS, MAGNET, ROAMING, kemi fituar angazhimin edhe në projektet në vijim: EARLY, DiLanEdu-WB, WB-Edu4Migration. Për të shkruar pak më shumë për projektet e fituara gjatë këtij viti akademik, ju përcjellim shkurtimisht sa në vijim:

Projekti EARLY synon të zvogëlojë barrën e sëmundjeve jo komunikuese siç janë kushtet e shëndetit mendor, veçanërisht depresioni, ankthi, çrregullimet e stresit, çrregullimet e përdorimit të substancave dhe të identifikojë dhe reduktojë ekspozimet e modifikueshme të rrezikshme për këto kushte tek të rinjtë. EARLY do të ndjekë këtë qëllim përmes zhvillimit të një matrice gjithëpërfshirëse ekspozimi e cila mund të përshtatet me rreziqet e reja që shfaqen, për të kuptuar perceptimet e të rinjve, prindërve dhe palëve të interesuara, ne do të kryejmë intervista cilësore, duke ofruar të dhëna përfaqësuese, shumëkombëshe për kushtet e shëndetit mendor të të rinjve dhe duke zhvilluar, zbatuar dhe vlerësuar një ndërhyrje me shumë komponente. Ky do të shërbejë si një model inovativ për promovimin e shëndetit mendor dhe parandalimin e kushteve të shëndetit mendor. EARLY është një studim me metoda të përziera që kombinon metodat cilësore dhe sasimore. Për të ofruar një pasqyrë të masave të shëndetit mendor të të rinjve, ne do të rishikojmë masat, për të ofruar të dhëna për faktorët e ekspozimit dhe nëse vlerësimet e ekspozimit ndryshojnë sipas vendit, moshës dhe gjinisë, ne do të rishikojmë studimet dhe do të identifikojmë dhe bashkojmë të dhënat e disponueshme për shëndetin mendor të të rinjve; për të ofruar njohuri mbi perceptimet, ne do të zhvillojmë fokus grupe me përdoruesit fundorë. Për të siguruar të dhëna përfaqësuese për kushtet e shëndetit mendor të të rinjve, ne do të kryejmë një anketë

ndërseksionale, të cilat janë të dhënat bazë për ndërhyrjen pilot me shumë komponentë në pesë vende të përzgjedhura. Për të siguruar të dhëna mbi efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve për të reduktuar kushtet e shëndetit mendor, ne do të kryejmë një ndërhyrje me shumë komponente.

Projekti DiLanEdu-WB. Në Epokën Dixhitale, meqenëse fëmijët kalojnë gjithnjë e më shumë kohë në botën dixhitale në kurriz të kohës së kaluar në ndërveprim fizik me fëmijët e tjerë, dixhitalizimi i mësimi të gjuhës është i domosdoshëm për të përmirësuar komunikimin oral, aftësitë gjuhësore dhe për të reduktuar ankthin në detyrat e të folurit. Nevoja për të integruar metodat dhe mjetet dixhitale në edukimin dhe studimin e gjuhës është identifikuar në Ballkanin Perëndimor, ku janë zhvilluar strategji për transformimin dixhital duke vendosur kompetencat dixhitale si një qëllim kryesor në transformimin e sistemeve të tyre arsimore. Problemet e zakonshme të identifikuara përfshijnë kualifikimin e pamjaftueshem të mësuesve, përfshirë edhe mësuesve të gjuhës, për të integruar mjetet dhe metodat dixhitale në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, si dhe mungesën e përmbajtjes dixhitale të përshtatshme në gjuhët e Ballkanit Perëndimor. Për këtë arsye, ky projekt synon të përmirësojë cilësinë e edukimit të gjuhës në Zonën e Arsimit të Lartë të Ballkanit Perëndimor duke forcuar kuriKolegji Universitar “LOGOS”at e trajnimit të mësuesve të gjuhës së IAL-ve pjesëmarrëse me TIK.

Projekti WB-Edu4Migration. Propozimi i projektit bazohet në njohjen e një hendeku kritik në kompetencat e punonjësve socialë në Kosovë dhe në Shqipëri, veçanërisht në lidhje me aftësinë e tyre për të mbështetur në mënyrë efektive popullatat migrante. Megjithë rëndësinë në rritje të trajtimit të çështjeve të migracionit brenda këtyre vendeve, institucionet arsimore që ofrojnë programe për punën sociale ende nuk kanë përfshirë plotësisht kurse të plota mbi studimet e migracionit dhe temat e lidhura me to. Ky hendek arsimor pengon aftësinë e punonjësve socialë për të kuptuar dhe trajtuar sfidat unike me të cilat përballen popullatat migrante, duke kërkuar ndërhyrje të mirësnuara për të kapërcyer këtë hendek.

Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare ka përcaktuar dhe trajnuar kordinatorët e FaKolegji Universitar “LOGOS”teteve në programet ERASMUS+, të cilët kanë gjeneruar dokumentin e protokoleve të procedurave të mobilitetit (“LOGOS, International Mobility Protocols”). Me sukses

KU “LOGOS” ka vijuar të punojë drejt synimeve të tij përgjatë këtij viti akademik duke zgjeruar partneritetet me institucione vendase dhe të huaja për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënit, kërkimin dhe punësimin e studentëve.

TABELA 2: INSTITUCIONE PARTNERE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “LOGOS”

Institucioni bashkëpunues	Shteti	Fusha e bashkëpunimit
Universiteti i Tiranës	Shqipëri	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Shqipëri	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Universiteti Bujqësor i Tiranës	Shqipëri	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë	Shqipëri	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	Shqipëri	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Universiteti Zoja e Këshillit të Mirë	Shqipëri	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë	Shqipëri	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Akademia “Ivodont”	Shqipëri	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Universiteti i Sporteve të Tiranës	Shqipëri	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Universiteti Luarasi	Shqipëri	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Universiteti i Pireut, Greqi	Greqi	Shkëmbimi i personelit akademik, studentëve, kërkimi, programe të përbashkëta
Akademia Universitare Ecclesiastical e Selanikut	Greqi	Shkëmbimi i personelit akademik, studentëve, kërkimi
Universiteti i Finlandës Lindore (UEF)	Filande	Shkëmbimi i personelit akademik dhe administrative, kërkimin
Universiteti i Neapolis, Qipro	Qipro	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Universiteti i Kretës	Greqi	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Universiteti Kombëtare Teknik i Athinës	Greqi	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Qendra KONFUCI	Shqipëri	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Universiteti Janinës	Greqi	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Universiteti Maqedonisë Perëndimore, Kozan	Greqi	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Center of Greek Language	Greqi	KU LOGOS njihet si Qendër për provimin e gjuhës greke në Tiranë
Universiteti i Oradeas, Rumani	Rumani	Shkëmbimi i personelit akademik, studentëve
Universiteti Shën Kirili A.D. 1669, Valletta, Malta	Malte	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
University of Western Macedonia	Greqi	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Janos University Hungary	Hungari	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Mediterranean University of Podgorica	Mal i zi	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Public International Business College Mitrovica (IBCM)	Kosovë	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
R.I.T Kosova College	Kosovë	Shkëmbimi i personelit akademik, kërkimi
Shkolla Teknologjike Ekonomike Tiranë	Shqipëri	Shkëmbimi i personelit akademik, praktika
Kuvendi i Shqipërisë	Shqipëri	Bashkëpunimi për të ofruar ekspertizë, bashkëpunimi për praktikë profesionale, shkëmbim literature
Kontrolli i Lartë i Shtetit	Shqipëri	Bashkëpunimi për të ofruar ekspertizë, bashkëpunimi për praktikë profesionale, shkëmbim literature

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Shqipëri	Bashkëpunimi për të ofruar ekspertizë, bashkëpunim për praktikë profesionale, shkëmbim literature
Keshilli Nderfetar i Shqiperise	Shqipëri	Bashkëpunimi për të ofruar ekspertizë, bashkëpunim për praktikë profesionale, shkëmbim literature
KOASH	Shqipëri	Bashkëpunimi për të ofruar ekspertizë, bashkëpunim për praktikë profesionale, shkëmbim literature
Europa Donna Albania	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Fondacioni “Frymë Dashurie”	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Bashkia Finiq	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Insituti i përkthimit “Flutura dhe Bijtë”	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Drejtoria e Përgjithshme e Kopshteve dhe Çerdheve	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Shkolla jopublike Shqiptaro-Greke “Frymë Dashurie”Durrës	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Shkolla jopublike Shqiptaro-Greke “Frymë Dashurie”Gjirokastër	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Shkolla e Mesme “Platon”, Korçë	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Shkolla e Mesme Kishtare jopublike “Kryqi i Nderuar”, Gjirokastër	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Shkolla e Mesme jopublike “Protagonistët”	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Shkolla Jopublike “Kristaq Rama”		Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Qendra Orthodokse Diagnostike “Ungjillëzimi”	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Spitali Amerikan	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Spitali Hygeia	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Urdhëri i Farmacistëve të Shqipërisë	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Laboratori Mjekësor “Intermedika” Tiranë	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Laboratori Biokimik Klinik (NEOSTIL)	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Shërbimi i Mikrobiologjisë Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Instituti i Modelimeve në Biznes	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Zyra e Kontabilitetit dhe Shërbimeve	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Shoqëria VJEN SHPK	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Ferma UKA	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Ferma Grabian	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
The Plaza Tirana	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
AZHBR (Agjensia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural)	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Consulting House shpk	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Agjensia Turistike “Zenith”	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Agjensi Turistike “Sondor Sh.p.k”	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Agjensi “1001 Albanian Adventures”	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Dhoma e Tregtisë Vlorë	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Dhoma e Tregtisë Durrës	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Kazazi Consulting shpk	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
OVI cons	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
ArkvizionES shpk	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Agjensia Turistike “Zenith”	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë

Agjensi Turistike “Sondor Sh.p.k”	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Agjensi “1001 Albanian Adventures”	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Ge Cons shpk	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Gur Shpat Energy	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Mar Energy shpk	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë
Studio Kontabiliteti Mimoza Mana	Shqipëri	Për veprimtari edukimi, kërkimi e praktikë

TABELA 3: BASHKËPUNIME ERASMUS+ 2023-2024

Institucioni bashkëpunues	Shteti	Fusha e bashkëpunimit	Kohëzgjatja e bashkëpunimit	Mobilitete të personelit 2023-2024
Universiteti i Pireut	Greqi	Finance Menaxhim Informatikë Pedagogji Administrim	2022-2027	U kryen vizita shkëmbim eksperience dhe mësimdhënie nga Logos në UP për 17 staf akademik, 10 staf administrativ dhe 11 studentë. 5 mobilitete per ardhjen e stafit akademik nga ky universitet
Universiteti i Oradeas, Rumani	Rumani	Menaxhim Administrim	2022-2027	3 mobilitete të personelit akademik nga Logos në OU; 5 mobilitete per ardhjen e stafit akademik nga ky universitet dhe 1 studentë
Democritus University of Thrace, Komotini	Greqi	Gjuha Greke	2022-2027	15 mobilitet i personelit akademik dhe administrativ nga Logos ne DUTH. 12 mobilitet i personelit akademik nga DUTH ne LOGOS dhe 2 studentë
Universiteti i Finlandës Lindore (UEF)	Filande	Theologjisë	2022-2025	5 mobilitet i personelit akademik dhe 3 administrativ nga Logos ne UEF 4 mobilitet i personelit akademik nga UEF ne LOGOS
International Hellenic University, Thessaloniki	Greqi	Shëndetsi	2022-2027	2 mobilitet i personelit akademik nga LOGOS ne

				IHU
Aristotli University of Thessaloniki	Greqi	Gjithë fushat	2022-2027	2 mobilitet i personelit akadmeik nga LOGOS në AUTH 1 mobilitet i personelit akadmeik nga AUTH në LOGOS
Panteion University of Social and Political Sciences	Greqi	Gjithë fushat	2022-2027	2 mobilitet i personelit akademik nga LOGOS në PU 1 mobilitet i personelit akademik nga PU në LOGOS
Universiteti Kretës	Greqi	Gjithë fushat	2022-2027	3 mobilitet i personelit akadmeik nga LOGOS në UC 5 mobilitet i personelit akadmeik nga UC ne LOGOS
University of Western Macedonia	Greqi	Gjithë fushat	2024-2029	2 mobilitet i personelit akademik nga LOGOS në WM 2 mobilitet i personelit akademik nga WM në LOGOS
Janos University Hungary	Hungari	Gjithë fushat	2023-2028	5 mobilitet i personelit akadmeik nga Logos ne Janos 5 mobilitet i personelit akadmeik nga Janos ne LOGOS

TABELA 4

Titulli i projektit	Erasmus+ Key 1: Mobilitet për të nxënë për individët
Lloji i projektit	Projekt mobiliteti për studentët dhe personelin e arsimit të lartë
Palët bashkëpunuese	Universiteti i Pireut, Greqi dhe Kolegji Universitar Logos, Shqipëri
Statusi i projektit	Në proces
Forma e zyrtarizimit të projektit	Marrëveshje ndërinstitucionale
Fusha e bashkëpunimit	Përvojë në mësimdhënie dhe të nxënë në fushën e menaxhimit, administrimit dhe të informatikës
Detyrat e palëve	Detyrat e UP • Zbatimi i kërkesave të Programit Erasmus+ në të gjitha aspektet e organizimit dhe menaxhimit të lëvizshmërisë, në veçanti njohjen e kredive (ose ekuivalenteve) që u jepen studentëve nga institucioni partner. • Institucioni angazhohet për një menaxhim transparent të fondeve të akorduara atyre nëpërmjet Erasmus +. • Zbatimi i kriterëve specifike të nivelit të gjuhës për studentët të përcaktuara në kontratë (niveli B2 në Anglisht). • Qartësimi i studentëve dhe stafit mbi procedurat e lëvizshmërisë, pagesat dhe qëndrimin. • Institucioni pritës do të informojë pjesëmarrësit në lëvizjen e Erasmus+ për rastet në të cilat mbulimi i sigurimit nuk është siguruar automatikisht. • Përgatitja dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së të nxënit për studentët. Detyrat e Kolegji Universitar “LOGOS” • Të përzgjedhë personelin akademik dhe studentët që do të jenë pjesë e mobilitetit sipas kriterëve të parashikuara për këtë projekt. • Të krijojë të gjitha kushtet e duhura për mobilitetin e personelit akademik që do të lëvizë nga Universiteti i Pireut për në Kolegjin Universitar “LOGOS”. • Nënshkrimi i marrëveshjes së të nxënit për studentët.
Pritshmëritë e projektit	• Shkëmbimi i përvojave në mësimdhënie dhe të nxënë. • Zgjerimi i kontakteve të bashkëpunimit. • Krijimi i rrjetit akademik.
Rezultate/ produkte të projektit për vitin 2023-2024	U kryen: • vizita shkëmbim eksperience dhe mësimdhënie nga Logos në UP për 17 staf akademik, 10 staf administrativ dhe 11 studentë. • 5 mobilitete për ardhjen e stafit akademik nga UP në LOGOS

TABELA 5

Titulli i projektit	Erasmus+ Key 1: Mobilitet për të nxënë për individët
Lloji i projektit	Projekt mobiliteti për studentët dhe personelin e arsimit të lartë
Palët bashkëpunuese	Universiteti i Oradeas, Rumani dhe Kolegji Universitar Logos, Shqipëri
Statusi i projektit	Në proces

Forma e zyrtarizimit të projektit	Marrëveshje ndërinstitutionale
Fusha e bashkëpunimit	Përvojë në mësimdhënie dhe të nxënë në fushën e menaxhimit dhe të informatikës
Detyrat e palëve	Detyrat e UO • Zbatimi i kërkesave të Programit Erasmus+ në të gjitha aspektet e organizimit dhe menaxhimit të lëvizshmërisë, në veçanti njohjen e kredive (ose ekuivalenteve) që u jepen studentëve nga institucioni partner. • Institucioni angazhohet për një menaxhim transparent të fondeve të akorduara atyre nëpërmjet Erasmus +. • Zbatimi i kriterëve specifike të nivelit të gjuhës për studentët të përcaktuara në kontratë (niveli B2 në Anglisht). • Qartësimi i studentëve dhe stafit mbi procedurat e lëvizshmërisë, pagesat dhe qëndrimin. • Institucioni pritës do të informojë pjesëmarrësit në lëvizjen e Erasmus+ për rastet në të cilat mbulimi i sigurimit nuk është siguruar automatikisht. • Përgatitja dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së të nxënës për studentët. Detyrat e Kolegji Universitar “LOGOS” • Të përzgjedhë personelin akademik dhe studentët që do të jenë pjesë e mobilitetit sipas kriterëve të parashikuara për këtë projekt. • Të krijojë të gjitha kushtet e duhura për mobilitetin e personelit akademik që do të lëvizë nga Universiteti i Oradeas për në Kolegji Universitar “LOGOS”. • Nënshkrimi i marrëveshjes së të nxënës për studentët.
Pritshmëritë e projektit	• Shkëmbimi i përvojave në mësimdhënie dhe të nxënës • Zgjerimi i kontakteve të bashkëpunimit. • Krijimi i rrjetit akademik
Rezultate/ produkte të projektit për vitin 2023-2024	• 3 mobilitete të personelit akademik nga Logos në OU; • dhe 1 studentë • 5 mobilitete për ardhjen e stafit akademik nga ky universitet

TABELA 6

Titulli i projektit	Erasmus+ Key 1: Mobilitet për të nxënë për individët
Lloji i projektit	Projekt mobiliteti për studentët dhe personelin e arsimit të lartë
Palët bashkëpunuese	Democritus University of Thrace, Komotini, Greqi dhe Kolegji Universitar Logos, Shqipëri
Statusi i projektit	Në process
Forma e zyrtarizimit të projektit	Marrëveshje ndërinstitutionale
Fusha e bashkëpunimit	Përvojë në mësimdhënie dhe të nxënë në fushën e menaxhimit dhe të informatikës
Detyrat e palëve	Detyrat e DUTH • Zbatimi i kërkesave të Programit Erasmus+ në të gjitha aspektet e organizimit dhe menaxhimit të lëvizshmërisë, në veçanti njohjen e

	kredive (ose ekuivalenteve) që u jepen studentëve nga institucioni partner. • Institucioni angazhohet për një menaxhim transparent të fondeve të akorduara atyre nëpërmjet Erasmus +. • Zbatimi i kriterëve specifike të nivelit të gjuhës për studentët të përcaktuara në kontratë (niveli B2 në Anglisht ose Frëngjisht). • Qartësimi i studentëve dhe stafit mbi procedurat e lëvizshmërisë, pagesat dhe qëndrimin. • Institucioni pritës do të informojë pjesëmarrësit në lëvizjen e Erasmus+ për rastet në të cilat mbulimi i sigurimit nuk është siguruar automatikisht. • Përgatitja dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së të nxënës për studentët. Detyrat e Kolegji Universitar “LOGOS” • Të përzgjedhë personelin akademik dhe studentët që do të jenë pjesë e mobilitetit sipas kriterëve të parashikuara për këtë projekt. • Të krijojë të gjitha kushtet e duhura për mobilitetin e personelit akademik që do të lëvizë nga DUTH për në Kolegji Universitar “LOGOS”. Nënshkrimi i marrëveshjes së të nxënës për studentët.
Pritshmëritë e projektit	• Shkëmbimi i përvojave në mësimdhënie dhe të nxënës • Zgjerimi i kontakteve të bashkëpunimit. • Krijimi i rrjetit akademik
Rezultate/ produkte të projektit për vitin 2023-2024	• 15 mobilitet i personelit akademik dhe administrativ nga Logos ne DUTH. • 12 mobilitet i personelit akademik nga DUTH ne LOGOS • dhe 2 studentë

Titulli i projektit	Erasmus+ Key 1: Mobilitet për të nxënës për individët
Lloji i projektit	Projekt mobiliteti për studentët dhe personelin e arsimit të lartë
Palët bashkëpunuese	Universiteti i Finlandës Lindore (UEF) dhe Kolegji Universitar Logos, Shqipëri
Statusi i projektit	Në proces
Forma e zyrtarizimit të projektit	Marrëveshje ndërinstitutionale
Fusha e bashkëpunimit	Përvojë në mësimdhënie dhe të nxënës në fushën e menaxhimit dhe të informatikës
Detyrat e palëve	Detyrat e UEF • Zbatimi i kërkesave të Programit Erasmus+ në të gjitha aspektet e organizimit dhe menaxhimit të lëvizshmërisë, në veçanti njohjen e kredive (ose ekuivalenteve) që u jepen studentëve nga institucioni partner. • Institucioni angazhohet për një menaxhim transparent të fondeve të akorduara atyre nëpërmjet Erasmus +. • Zbatimi i kriterëve specifike të nivelit të gjuhës për studentët të përcaktuara në kontratë (niveli B2 në Anglisht). • Qartësimi i studentëve dhe stafit mbi procedurat e lëvizshmërisë, pagesat dhe qëndrimin.

	• Institucioni pritës do të informojë pjesëmarrësit në lëvizjen e Erasmus+ për rastet në të cilat mbulimi i sigurimit nuk është siguruar automatikisht. • Përgatitja dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së të nxënësve për studentët. Detyrat e Kolegji Universitar “LOGOS” • Të përzgjedhë personelin akademik dhe studentët që do të jenë pjesë e mobilitetit sipas kriterëve të parashikuara për këtë projekt. • Të krijojë të gjitha kushtet e duhura për mobilitetin e personelit akademik që do të lëvizë nga Universiteti i Finlandës Lindore (UEF) për në Kolegji Universitar “LOGOS”. • Nënshkrimi i marrëveshjes së të nxënësve për studentët.
Pritshmëritë e projektit	• Shkëmbimi i përvojave në mësimdhënie dhe të nxënësve • Zgjerimi i kontakteve të bashkëpunimit. • Krijimi i rrjetit akademik
Rezultate/ produkte të projektit për vitin 2023-2024	• 5 mobilitet i personelit akademik dhe 3 administrativ nga Logos ne UEF • 4 mobilitet i personelit akademik nga UEF ne LOGOS

Titulli i projektit	Erasmus+ Key 1: Mobilitet për të nxënësve për individët
Lloji i projektit	Projekt mobiliteti për studentët dhe personelin e arsimit të lartë
Palët bashkëpunuese	International Hellenic University, Thessaloniki dhe Kolegji Universitar Logos, Shqipëri
Statusi i projektit	Në proces
Forma e zyrtarizimit të projektit	Marrëveshje ndër-institucionale
Fusha e bashkëpunimit	Përvojë në mësimdhënie dhe të nxënësve në fushën e menaxhimit dhe të informatikës
Detyrat e palëve	Detyrat e IHU • Zbatimi i kërkesave të Programit Erasmus+ në të gjitha aspektet e organizimit dhe menaxhimit të lëvizshmërisë, në veçanti njohjen e kredive (ose ekuivalenteve) që u jepen studentëve nga institucioni partner. • Institucioni angazhohet për një menaxhim transparent të fondeve të akorduara atyre nëpërmjet Erasmus +. • Zbatimi i kriterëve specifikë të nivelit të gjuhës për studentët të përcaktuar në kontratë (niveli B2 në Anglisht). • Qartësimi i studentëve dhe stafit mbi procedurat e lëvizshmërisë, pagesat dhe qëndrimin. • Institucioni pritës do të informojë pjesëmarrësit në lëvizjen e Erasmus+ për rastet në të cilat mbulimi i sigurimit nuk është siguruar automatikisht. • Përgatitja dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së të nxënësve për studentët. Detyrat e Kolegji Universitar “LOGOS” • Të përzgjedhë personelin akademik dhe studentët që do të jenë pjesë e mobilitetit sipas kriterëve të parashikuara për këtë projekt.

	• Të krijojë të gjitha kushtet e duhura për mobilitetin e personelit akademik që do të lëvizë nga International Hellenic University, Thessaloniki për në Kolegji Universitar “LOGOS”. • Nënshkrimi i marrëveshjes së të nxënësve për studentët.
Pritshmëritë e projektit	• Shkëmbimi i përvojave në mësimdhënie dhe të nxënësve • Zgjerimi i kontakteve të bashkëpunimit. • Krijimi i rrjetit akademik
Rezultate/ produkte të projektit për vitin 2023-2024	• 2 mobilitet i personelit akademik nga LOGOS në IHU

Titulli i projektit	Erasmus+ Key 1: Mobilitet për të nxënësve për individët
Lloji i projektit	Projekt mobiliteti për studentët dhe personelin e arsimit të lartë
Palët bashkëpunuese	Aristotli University of Thessaloniki dhe Kolegji Universitar Logos, Shqipëri
Statusi i projektit	Në proces
Forma e zyrtarizimit të projektit	Marrëveshje ndërinstitucionale
Fusha e bashkëpunimit	Përvojë në mësimdhënie dhe të nxënësve në fushën e menaxhimit dhe të informatikës
Detyrat e palëve	Detyrat e AUTH • Zbatimi i kërkesave të Programit Erasmus+ në të gjitha aspektet e organizimit dhe menaxhimit të lëvizshmërisë, në veçanti njohjen e kredive (ose ekuivalenteve) që u jepen studentëve nga institucioni partner. • Institucioni angazhohet për një menaxhim transparent të fondeve të akorduara atyre nëpërmjet Erasmus +. • Zbatimi i kriterëve specifikë të nivelit të gjuhës për studentët të përcaktuar në kontratë (niveli B2 në Anglisht). • Qartësimi i studentëve dhe stafit mbi procedurat e lëvizshmërisë, pagesat dhe qëndrimin. • Institucioni pritës do të informojë pjesëmarrësit në lëvizjen e Erasmus+ për rastet në të cilat mbulimi i sigurimit nuk është siguruar automatikisht. • Përgatitja dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së të nxënësve për studentët. Detyrat e Kolegji Universitar “LOGOS” • Të përzgjedhë personelin akademik dhe studentët që do të jenë pjesë e mobilitetit sipas kriterëve të parashikuara për këtë projekt. • Të krijojë të gjitha kushtet e duhura për mobilitetin e personelit akademik që do të lëvizë nga Aristotli University of Thessaloniki për në Kolegji Universitar “LOGOS”. • Nënshkrimi i marrëveshjes së të nxënësve për studentët.
Pritshmëritë e projektit	• Shkëmbimi i përvojave në mësimdhënie dhe të nxënësve • Zgjerimi i kontakteve të bashkëpunimit. • Krijimi i rrjetit akademik

Rezultate/ produkte të projektit për vitin 2023-2024	• 2 mobilitet i personelit akademik nga LOGOS në AUTH • 1 mobilitet i personelit akademik nga AUTH në LOGOS
--	--

Titulli i projektit	Erasmus+ Key 1: Mobilitet për të nxënë për individët
Lloji i projektit	Projekt mobiliteti për studentët dhe personelin e arsimit të lartë
Palët bashkëpunuese	Panteion University of Social and Political Sciences dhe Kolegji Universitar Logos, Shqipëri
Statusi i projektit	Në proces
Forma e zyrtarizimit të projektit	Marrëveshje ndër-institucionale
Fusha e bashkëpunimit	Përvojë në mësimdhënie dhe të nxënë në fushën e menaxhimit dhe të informatikës
Detyrat e palëve	Detyrat e PU • Zbatimi i kërkesave të Programit Erasmus+ në të gjitha aspektet e organizimit dhe menaxhimit të lëvizshmërisë, në veçanti njohjen e kredive (ose ekuivalenteve) që u jepen studentëve nga institucioni partner. • Institucioni angazhohet për një menaxhim transparent të fondeve të akorduara atyre nëpërmjet Erasmus +. • Zbatimi i kriterëve specifike të nivelit të gjuhës për studentët të përcaktuara në kontratë (niveli B2 në Anglisht). • Qartësimi i studentëve dhe stafit mbi procedurat e lëvizshmërisë, pagesat dhe qëndrimin. • Institucioni pritës do të informojë pjesëmarrësit në lëvizjen e Erasmus+ për rastet në të cilat mbulimi i sigurimit nuk është siguruar automatikisht. • Përgatitja dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së të nxënës për studentët. Detyrat e Kolegji Universitar “LOGOS” • Të përzgjedhë personelin akademik dhe studentët që do të jenë pjesë e mobilitetit sipas kriterëve të parashikuara për këtë projekt. • Të krijojë të gjitha kushtet e duhura për mobilitetin e personelit akademik që do të lëvizë nga Panteion University of Social and Political Sciences për në Kolegji Universitar “LOGOS”. • Nënshkrimi i marrëveshjes së të nxënës për studentët.
Pritshmëritë e projektit	• Shkëmbimi i përvojave në mësimdhënie dhe të nxënë • Zgjerimi i kontakteve të bashkëpunimit. • Krijimi i rrjetit akademik
Rezultate/ produkte të projektit për vitin 2023-2024	• 1 mobilitet i personelit akademik nga LOGOS në PU • 1 mobilitet i personelit akademik nga PU në LOGOS

Titulli i projektit	Erasmus+ Key 1: Mobilitet për të nxënë për individët
Lloji i projektit	Projekt mobiliteti për studentët dhe personelin e arsimit të lartë
Palët bashkëpunuese	University of Crete dhe Kolegji Universitar Logos, Shqipëri

Statusi i projektit	Në proces
Forma e zyrtarizimit të projektit	Marrëveshje ndërinstytucionale
Fusha e bashkëpunimit	Përvojë në mësimdhënie dhe të nxënë në fushën e menaxhimit dhe të informatikës
Detyrat e palëve	Detyrat e UC • Zbatimi i kërkesave të Programit Erasmus+ në të gjitha aspektet e organizimit dhe menaxhimit të lëvizshmërisë, në veçanti njohjen e kredive (ose ekuivalenteve) që u jepen studentëve nga institucioni partner. • Institucioni angazhohet për një menaxhim transparent të fondeve të akorduara atyre nëpërmjet Erasmus +. • Zbatimi i kriterëve specifike të nivelit të gjuhës për studentët të përcaktuara në kontratë (niveli B2 në Anglisht). • Qartësimi i studentëve dhe stafit mbi procedurat e lëvizshmërisë, pagesat dhe qëndrimin. • Institucioni pritës do të informojë pjesëmarrësit në lëvizjen e Erasmus+ për rastet në të cilat mbulimi i sigurimit nuk është siguruar automatikisht. • Përgatitja dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së të nxënës për studentët. Detyrat e Kolegji Universitar “LOGOS” • Të përzgjedhë personelin akademik dhe studentët që do të jenë pjesë e mobilitetit sipas kriterëve të parashikuara për këtë projekt. • Të krijojë të gjitha kushtet e duhura për mobilitetin e personelit akademik që do të lëvizë nga University of Crete për në Kolegji Universitar “LOGOS”. • Nënshkrimi i marrëveshjes së të nxënës për studentët.
Pritshmëritë e projektit	• Shkëmbimi i përvojave në mësimdhënie dhe të nxënës • Zgjerimi i kontakteve të bashkëpunimit. • Krijimi i rrjetit akademik
Rezultate/ produkte të projektit për vitin 2023-2024	• 2 mobilitet i personelit akademik nga LOGOS në UC • 5 mobilitet i personelit akademik nga PU në LOGOS

c) INFORMACION PËR KËRKIMIN SHKENCOR

Politika e kërkimit shkencor

Kolegji Universitar “LOGOS” ka punuar për ta realizuar kërkimin shkencor në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe përcaktimet në Statut.

Kërkimi shkencor është përcaktuar si prioritet strategjik në Planin Strategjik të Zhvillimit 2018-2024. Politika e kërkimit shkencor ka në bazë këto parime kryesore.

1. Kalimi nga qasja individuale në qasjen bashkëpunuese në kërkim. Kjo qasje është pranuar për disa arsye: a) Kërkimi është më efektiv kur studiuesit me ekspertizë nga fusha të ndryshme bashkëpunojnë në një projekt kërkimi të përbashkët. b) Sa më shumë studiues të bashkëpunojnë, aq më të mëdha janë shanset për sukses dhe zgjidhjen e problemeve. c) Në rastin e Kolegjit Universitar “LOGOS”, kur burimet janë relativisht të kufizuara, bashkëpunimi bëhet veçanërisht i vlefshëm si një mjet për të fituar njohuri dhe përvojë. d) Bashkëpunimi me ekipe të tjera hulumtuese e bën kërkimin një proces më të lehtë, duke shkëmbyer informacione mbi situata të ngjashme me të tjerët dhe duke përdorur teknikat dhe përvojat e tyre më të suksesshme. Kjo qasje i jep përparësi veprimtarisë kërkimore në nivelin e njësisë bazë dhe të kolegjit. Kjo qasje nuk e përjashton veprimtarinë individuale, pasi në bazë të legjislacionit në fuqi, kërkimi është një komponent i ngarkesës së punës të personelit akademik dhe është një produkt që përdoret për qëllimin individual të lidhur me promovimin në karrierën akademike.

2. Kryerja e kërkimeve që të kenë ndikim në shoqëri. Duke vlerësuar se kërkimi shkencor ka ndikime të konsiderueshme në shoqëri, Kolegji Universitar “LOGOS” ka përcaktuar si një parim kryesor kryerjen e kërkimeve për çështje që i interesojnë shoqërisë në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm, në fushën e dialogut dhe tolerancës ndërfetare, në fushën e shkencave të shëndetit, në fushën e arsimit parashkollor, në fushën e edukimit ndërKolegji Universitar “LOGOS”turor, në fushën e edukimit financiar.

3. Ndërthurja e kërkimit me mësimdhënien. Kolegji Universitar “LOGOS” synon që pedagogët të jenë kërkues aktivë që ata të transferojnë në mënyrë të natyrshme rezultatet e kërkimit në mësim; që mësimi të aftësojë studentët të ushtrohen për detyra kërkimore të vogla; që mësimi të ilustruhet me arritjet shkencore të fushës.

4. Zhvillimi i aftësive kërkimore të studentëve. Sipas këtij parimi, Kolegji Universitar “LOGOS” synon që specialistët e ardhshëm të kenë kapacitetin të integrojnë kërkimin në praktikën e tyre profesionale: për shkak të natyrës praktike të profesioneve për të cilat ata përgatiten; për shkak se ata duhet të zbulojnë dhe analizojnë problemet që mund të ndeshin në punën e tyre të ardhshme; për shkak se ata duhet të jenë të aftë të studiojnë dhe të zhvillojnë praktikën e tyre profesionale në vijimësi.

Për të realizuar këto politika edhe përgjatë vitit 2023-2024 stafi akademik i çdo fakulteti në KOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS” ka vijuar me kërkimin shkencor përmes bashkëpunimeve në kërkime me pedagogë por edhe studentë duke realizuar ndërthurjen e mësimdhënies me kërkimin për punime që kanë ndikim në shoqëri.

Informacion për lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien

Në përgjigje të kësaj pike të raportit vjetor dhe duke ditur qasjen e hershme ku studentët konsideroheshin më tepër konsumatorë sesa prodhues të kërkimit, gjatë vitit 2023-2024 veprimtaritë mësimore janë organizuar në mënyrë të tillë që studentët të praktikojnë argumentimin, studimin e rasteve, marrjen e vendimeve dhe paraqitjen e arsyetimeve kur hulumtojnë për zgjidhjen e problemeve, kryerjen e detyrave me elemente të kërkimit dhe angazhimin e tyre në kërkim shkencor përmes plotësimit të pyetësorëve, kryerjen e intervistave dhe finalizimin e një pjese prej tyre si pjesëmarrës në konferencën studentore të organizuar pranë Kolegjit Universitar “Logos”. Prej disa vitesh bazuar në eksperiencat e mira të krijuara që prej kufizimeve të ndërmarra si rrjedhojë e pandemisë COVID-19 këto aktivitete mundësohen të realizohen në sallë dhe online për ata studentë dhe pedagogë të cilët nuk mundën të jenë fizikisht në sallë.

Gjithashtu lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien u realizua edhe udhëheqjen e dhjetra temave të diplomave të studentëve në programet e studimit në nivelit bachelor dhe ata në programet e studimit në nivel master.

Në përfundim, për të realizuar lidhjen e mësimdhënies me kërkimin, gjatë vitit akademik 2023-2024 u përdorën qasjet:

- *mësimdhënia e udhëhequr nga kërkimi*, e cila u realizua nëpërmjet integritit në mësimdhënie të rezultateve të kërkimeve aktuale sipas disiplinave mësimore;
- *mësimdhënia e orientuar drejt kërkimit*, e cila u realizua nëpërmjet të kuptuarit dhe zbatimit të metodologjive, aftësive dhe teknikave të kërkimit në disiplina mësimore;
- *mësimdhënia e bazuar në mentorimin kërkimor*, e cila u realizua nëpërmjet mentorimit të pedagogëve për punimet e diplomës; për vlerësimin e punimeve shkencore;
- *mësimdhënia e bazuar në kërkim*, e cila u realizua nëpërmjet detyrave kërkimore të shkallës së vogël në lëndë të veçanta; si ese, studim rasti, analiza klinike;

- *kërkimi është i ndikuar nga mësimdhënia*, e cila u realizua nëpërmjet përfshirjes së studentëve në mbledhjen e të dhënave, të analizës së të dhënave dhe të kryrjes së rolit të vlerësuesit për punimet për konferencën e studentëve.

Produktet në fushën e kërkimit shkencor dhe të zhvillimit

Në përgjigje të kësaj pike të raportit vjetor do të merrni informacion përmes tabelës 7, ku përmbledhen të dhënat referuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave 112, datë 23.02.2018, si edhe VKM 808, i datës 11.12.2019, për disa ndryshime në VKM 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kërkesave për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, por edhe bazuar në praktikën e mira të institucionit.

Tabela 7

Nr.	Lloj Publikimi	KU “LOGOS”
1)	Artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore ndërkombëtare me factor impakti, të rankuara nga Thomson Reuters dhe/ose Scopus.	16
2)	Artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore ndërkombëtare të indeksuara me kod ISSN.	13
3)	Artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore Brenda vendit të indeksuara me kod ISSN.	23
4)	Referimet e mbajtura në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-s, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe punimi i plotë i botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.	44
5)	Referime të mbajtura në veprimtari shkencore kombëtare apo ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe punimi i plotë i botuar në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.	32
6)	Monografi shkencore, e botuar jashtë vendit e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D.	1 kapitull
7)	Monografi shkencore, e botuar Brenda vendit, e cila duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “Profesorë” të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet e BE-së, OECD-së ose G20-s;	7
8)	Pjesëmarrje në: a)komitete shkencore apo redaktuese; b)veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë; c)projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar; ç) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar; d)projekte të financuara nga programe me donator të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit; dh) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare; e)si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare; ë) projektet e transferimit teknologjik të patentave.	a) 9 b) 10 c) 23 ç) 2 d) 5 dh) 2 e)6 ë)0
9)	Referime të mbajtura në veprimtari shkencore kombëtare apo ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe abstrakti i botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.	25

Veprimtari Zhvillimi-Kërkimore-Shkencore përgjatë vitit akademik 2023-2024

Fakulteti Ekonomik gjatë vitit akademik 2023-2024 ka organizuar me stafin e vet akademik dhe të ftuar disa trajnime, leksione të hapura dhe konferenca studentore. Disa prej atyre më të spikaturave për vitin akademik 2023-2024 paraqiten si në vijim:

<i>Nr</i>	<i>Muaji/viti</i>	<i>Tematika</i>	<i>Pedagogu/I ftuari</i>
1	Tetor 2023 - Maj 2024	Seanca Trajnimi dhe Mentorimi për studentë dhe maurantë të shkollave të mesme për edukimin financiar dhe sipërmarrës në kuadër të projektit OASIS	Prof.Dr. Artur Ribaj Dr. Emira Spahaj Dr. Romina Radonshiqi Dr. Olda Çiço, etj.
2	Shkurt 2024	Leksion i hapur: fusha Agrobiznes	Prof.Assoc.Dr. Gjergji Papa
3	Shkurt 2024	Organizim studentor me prezantim të punimeve të vitit të parë, të dytë dhe të tretë të programeve të studimit në FE	Dr. Olda Çiço, etj.
4	Mars – Prill – Maj - Qershor 2024	Leksione të hapura për Ekonominë me maurantë të shkollave të mesme: “Protagonistët”, “Teknike-Ekonomike”, “Frymë Dashurie” Tiranë, Durrës, Korçë	Prof.Dr. Artur Ribaj Dr. Emira Spahaj Dr. Romina Radonshiqi Dr. Olda Çiço, etj.
5	Prill 2024	Leksion i hapur: fondet e pensioneve	Shoqëria e Administrimit Raiffeisen dhe Prof.Dr. Artur Ribaj
6	Prill 2024	Vizitë e Departamentit të Agrobiznesit me studentët në Fermën ‘‘Eno Fama’’& BioBes, Lushnjë	Departamenti Agrobiznesit
7	Maj 2024	Konkurs: Ide inovative të studentëve dhe maurantëve (në kuadër të projektit OASIS)	Dr. Emira Spahaj
8	3 Qershor 2024	<u>Konferencë IV studentore</u> : “Ekonomia dhe Dimensioni Social”, Me fokus në: Inovacionin; Akselerimi i një brezi të ri, të sipërmarrjes studentore;	Prof.Dr. Artur Ribaj Dr. Emira Spahaj Dr. Romina Radonshiqi Dr. Olda Çiço Stafi FE Studentë
9	4 Qershor 2024	<i>Leksion i hapur</i> : fusha Informatikë Inteligjenca Artificiale	Prof.Dr. Ilia Ninka

Gjithashtu stafi pedagogjik dhe studentet e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit Universitar Logos, përgjatë vitit akademik 2023 – 2024, kanë marrë pjesë në disa Workshope, specializime, konkurse, etj., ku ndër të tjera përmendim:

<i>Nr</i>	<i>Muaji/viti</i>	<i>Workshop/Trajnimi/ Konkurs</i>
-----------	-------------------	-----------------------------------

1	Tetor 2023	Pjesëmarrja e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit Universitar “Logos” në konkursin e dytë rajonal me skuadra nga të gjitha fakultetet e ekonomisë të univeristeteve publike e private "Stock Market Learning Competition" <i>(Sparkassenstiftung Albania në bashkëpunim me AMF, ASTA dhe ALSE)</i>
2	20 Dhjetor 2023	“Filozofia dhe karakteristikat e kurrikulës së re, bazuar mbi kompetenca” <i>(Prof. Dr. Erlehta Mato dhe Prof. Dr. Artur Ribaj në kuadër të projektit Magnet)</i>
3	31 Janar 2024	"Zhvillimi i Turizmit të Qëndrueshëm në Shqipëri" (RisiAlbania)
4	29 Mars 2024	Ceremonia e Çmimeve të "Stock Market Learning Competition, Skuadra e Fakultetit Ekonomik fitoi vendin e dytë për rritje të qëndrueshme të portofolit të investuar <i>(Deutsche Sparkassenstiftung dhe Autoriteti Mbikëqyrës Financiar Shqiptar (AMF)</i>
5	26 Qershor 2024	"Roli i Arsimit të Lartë në Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve" Dr. Khalil Ghassan, përfaqësuesi i UNICEF-it

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara gjatë vitit akademik 2023-2024 ka organizuar me stafin e vet akademik dhe të ftuar disa veprimtari si konferenca, webinars, leksione të hapura, etj. Disa prej atyre më të spikaturave për vitin akademik 2023-2024 paraqiten si në vijim:

<i>Nr</i>	<i>Muaji/viti</i>	<i>Tematika</i>	<i>Pedagogu</i>
1	Tetor 2023	Leksion i hapur, në bashkëpunim me shoqatën Europa Dona, në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit kundër kancerit të Gjirit. Ndërgjegjësimi dhe kontrollet Shëndetësore.	Donjeta Zeqo, Prof.Asoc Oltiana Petri.
2	Prill 2024	Testim të parametrave Biokimik me stafin e Kolegjit Universitar "LOGOS"	DSHM
3	Maj 2024	Konferenca Studentore me temë Arritjet e reja në Shkencat e Aplikuara dhe Sfidat për të Ardhmen”	Studentë dhe pedagogë të FSHA

4	Maj 2024	Medical Laboratory Teaching “Unlocking the Power of Laboratory Tests in Healthcare” A Comprehensive MOOC. Online Course.	Prof.Asoc.Dr.Ridvana Mediu
5	Maj 2024	MOOC (Masive Open online Course) me titull Mastering Medical Education: Strategies for effective teaching and learning	Dr. Dorian Minxuri

Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor gjatë vitit akademik 2023-2024 ka organizuar me stafin e vet akademik dhe të ftuar disa trajnime, leksione të hapura dhe konferenca studentore. Disa prej atyre më të spikaturave për vitin akademik 2023-2024 paraqiten si në vijim:

<i>Nr</i>	<i>Muaji/viti</i>	<i>Tematika</i>	<i>Pedagogu/I ftuari</i>
1	21.05.2024	Dita e Studiuesit (Punimet e konferencës)	Aktivitet kolektiv
2	20.05.2024	Simpoziumi i XIII Ndërfetar	Aktivitet kolektiv
3	10.05.2024	<i>Aktivite sportive në suazë të javë së lojrave olimpike</i>	Aktivitet kolektiv
4	10.06.2024	Aktivite ushtrimore gjimnasdtike te Kopshti Protagonistët	Aktivitet kolektiv
5	4-6.12.2024	Kick-Off Meeting <i>Homo Digitalis</i>	Aktivitet kolektiv
6	24-25.05.2024	Konferenca <i>Loja dhe Aktivitetet në Natyre</i>	Aktivitet kolektiv
7	19.04.2024	Konferenca Ndërkombëtare Studentore “Sfidat e Shërbimit Social Pedagogjik dhe Psikologjik”	Aktivitet kolektiv
8	09.02.2024	<i>International Day for Greek language, Lecture and Exhibition about Aristotle</i>	Key Lecturer: Em. Prof. Demetra Sfondoni Metzou, (9/2/2024)

9	05.04.2024	Online open lecture, <i>The Image of the Albanian Other in Modern Greek Prose: From the 19th Century to the Contemporary Era</i>	Lecturer: Dr Petros Marazopoulos (05/04/2024)
10	15.04.2024	Hybrid open lecture, <i>Animals in Homer: Homeric Dogs and Odysseus</i>	Lecturer: Prof Flora Manakidou (15/04/2024)
11	15.05.2024	Screening of the Greek film <i>Η Φόνισσα (The Murseress)</i> (15/05/2024)	-

Gjithashtu stafi pedagogjik dhe studentet e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit Universitar “LOGOS”, përgjatë vitit akademik 2023 – 2024, morën pjesë në disa Workshope nga Qendra e Mësimdhënies dhe të Nxëniet si edhe nga Njësia Mbështetëse për Kërkim, Inovacion dhe Zhvillim të LOGOS:

<i>Nr</i>	<i>Muaji/viti</i>	<i>Workshop/Trajnimi/ Konkurs</i>
1	20.12.2023	Philosophy and characteristics of the new curriculum. Competency-based curriculum
2	22.02.2024	Ndërkombëtarizimi përmes kërkimit shkencor, inovacionit & zhvillimit dhe mundësitë përkatëse të financimit

Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor

Kolegji Universitar “LOGOS” ka vënë në dispozicion të kërkimit shkencor 12 laboratore (qendra për sipërmarrje dhe inovacion, atelie për pedagogjinë, laborator i gjuhës greke, 5 laboratorë të teknikës së lartë të laboratorëve dhe 3 laboratorë të informatikës si dhe një laborator me programet e posaçme për përpunimin e të dhënave ekonomike). (*Shih të plotë informacionin tek seksioni B/f*). Gjithashtu, në ndihmë të realizimit të synimeve të kërkimit shkencor janë dy biblioteka me fondin e tyre të materialeve të printuara dhe digjitale.

Infrastruktura mbështetëse e kërkimit shkencor përfshin njësi kompjuterike dhe akses në një sërë databazash elektronike në të cilat merr pjesë biblioteka institucionale (p.sh. JSTOR dhe EBSCO),

por edhe në disa databaza të vëçanta për hulumtim theologjik, të tillë si *Diogenes*, *Tesaurus Linguae Graecae* dhe *BibleWorks*.

Duke analizuar veprimtarinë kërkimore të zhvilluar gjatë vitit akademik 2023-2024, arrijmë në përfundimin se duhet punuar për të përcaktuar fushat e projekteve të kërkimit; për të përcaktuar projektet konkrete të kërkimit në nivel departamenti dhe faKolegji Universitar “LOGOS”teti.

Në këtë kuadër, sfidë e vazhdueshme mbetet që kërkimi i studentëve të lidhet me projektet e kërkimit të departamentit, gjë që ende është një sfidë. Ky është një synim që do të jetë në fokus edhe në vitet që vijnë derisa të arrijmë që të krijojmë traditën në këtë aspekt. Kështu studentët do të jenë të aftë të përfshihen në veprimtarinë reale kërkimore të Kolegjit.

Buxheti vjetor dhe ai afatmesëm parashikon fonde lidhur me kërkimin shkencor si dhe trajnimin apo rritjen profesionale te personelit akademik.

d) INFORMACION PËR PROGRAMET E STUDIMIT QË OFRON KOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”

Programet e Kolegjit Universitar “LOGOS” synojnë të përgatisin specialistë për fusha vitale, si: të shëndetit, të ekonomisë, të arsimit, të mirëqenies sociale, të teknologjisë së informacionit, të teologjisë, të komunikimit, të agrobiznesit.

alumni

Gjatë vitit 2023-2024, Kolegji Universitar “LOGOS” ka ofruar 16 programe studimi, dhjetë programe bachelor, tre programe master profesional, dy programe master shkencor dhe 1 program me karakter profesional 2 vjeçar. Të gjithë programet kanë status aktiv. (Shih tabela 8)

Programi i studimit “Bachelor në Financë-Kontabilitet” është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 180 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Financë-Kontabilitet”. Misioni i

programit “Bachelor në Financë-Kontabilitet” është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme bazë në fushën e financë-kontabilitetit, menaxhimit dhe ekonomisë dhe t’u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t’u përgatitur si specialistë të financës dhe kontabilitetit në njësitë e vogla e të mesme të sektorit publik dhe privat. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime në fusha të tilla, si ato të financës, të kontabilitetit, të informatikës dhe të statistikës, të mikro dhe makroekonomisë, të legjislacionit të biznesit, etj.

Programi i studimit “Bachelor në Menaxhim Biznesi” është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 180 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Menaxhim Biznesi”. Misioni i programit “Bachelor në Menaxhim Biznesi” është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme bazë në fushën e menaxhimit dhe të marketingut dhe t’u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t’u përgatitur si specialistë të menaxhimit, të marketingut në njësi të vogla e të mesme të sektorit publik dhe privat. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime në fusha të tilla, si ato të mikro dhe makroekonomisë, të legjislacionit të biznesit, të financës, të kontabilitetit, të informatikës dhe të statistikës, etj.

Programi i studimit “Bachelor në Menaxhim Turizmi” është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 180 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Menaxhim Turizmi”. Misioni i programit “Bachelor në Menaxhim Turizmi” është formimi i specialistëve në fushën e menaxhimit të turizmit. Programi në vitin e fundit të studimeve është me natyrë aplikative dhe ofron formim kryesisht praktik për të garantuar një karrierë të suksesshme.

Programi i studimit “Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 180 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”. Misioni i programit “Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë “ është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme bazë në fushën e teknikës së lartë në laboratorët mjekësorë dhe t’u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t’u përgatitur si specialistë në këtë fushë. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime në fusha të tilla, si mikrobiologjia, biokimia, histopatologjia, imunologjia, diagnostika molekulare Kolegji Universitar “LOGOS”are, teknika laboratorike etj.

Programi i studimit “Bachelor në Informatikë të Zbatuar” është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 180 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Informatikë të Zbatuar”. Misioni i programit “Bachelor në Informatikë të Zbatuar” është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme bazë në fushën e informatikës dhe t’u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t’u përgatitur si specialistë në këtë fushë. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime në fusha të tilla, si gjuhë programimi, teori dhe praktikë rrjetash kompjuterike, sisteme operative, teknologji informacioni, zhvillim i faqes web, etj.

Programi i studimit “Bachelor në Studime në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze” është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 180 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Studime në Teologji Sociale dhe Shkenca Religjioze”. Misioni i programit “Bachelor në Studime në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze” është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme bazë në fushën e teologjisë sociale dhe shkencave religjioze. Programi është i përqendruar në teologjinë ortodokse dhe besimin në një mjedis të krishterë ortodoks. Programi i përgatit studentët sesi të përdorin disa teori moderne të shkencave shoqërore për studimin e fesë, të kuptojnë ndikimin e fesë në shoqëri. Nëpërmjet studimit të gjerë mbi studimet biblike dhe patristike, teologjinë e krishterë, historinë e feve, historinë dhe traditën e Kishës Autoqefale të Shqipërisë, studentët kuptojnë dhe vlerësojnë rolin e teologjisë ortodokse në shoqëri. Ky program prezanton disa nga

diskutimet më sfiduese filozofike dhe etike të të gjitha kohërave, duke prezantuar mendimtarët më të mëdhenj teologjikë të së kaluarës. Studentët përgatiten të shprehin mendimin e tyre kritik, ndërsa zhvillojnë aftësi në gjuhë të huaja, informatikë, gazetari dhe media sociale.

Programi i studimit “Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek” është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 180 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën greke. Ky program studimi i takon nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek”. Misioni i programit “Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek” është të pajisë studentët me kompetencën e zotërimit të gjuhës greke, që u mundëson atyre komunikimin në kontekste të ndryshme gjatë karrierës; të njohë studentët me origjinën, zhvillimin, arritjet, vlerat e civilizimit grek; të aftësojë studentët të kuptojnë rolin dhe ndikimin e këtij civilizimi në zhvillimin e shoqërisë njerëzore; të zhvillojë te studentët kompetencën globale dhe ndërkulturore. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime në fusha të tilla, si linguistika, letërsia, historia, kultura, etj.

Programi i studimit “Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 180 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor”. Misioni i programit “Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor” është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme bazë në fushën e arsimit parashkollor dhe t’u zhvillojë atyre kompetencat e nevojshme për t’u përgatitur si mësues të arsimit parashkollor. Programi bazohet në një kornizë konceptuale të teorisë aktuale, perspektivave bashkëkohore dhe gjetjeve të kërkimit shkencor në fushën e arsimit parashkollor. Programi përqendrohet në zhvillimin e njohurive, qëndrimeve, aftësive, në praktikën, reflektimin dhe përvojat në terren, të nevojshme për t’u bërë profesionist kompetent në fushën e arsimit parashkollor. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime në fusha të tilla, si psikologjia e zhvillimit, psikologjia e edukimit, pedagogjia speciale, pedagogjia familjare, vlerësimi i fëmijës së moshës parashkollore, kurrikula, metodologjia e

mësimdhënies, metodika speciale, gjuhësia, matematika, shkencat shoqërore, shkencat e natyrës, artet, sportet, teknologjia e informacionit, shkencat e shëndetit.

Programi i studimit Bachelor në “Gjuhë-Letërsi Angleze dhe Teknologji Përkthimi”

Misioni i programit të studimit është që, përmes formimit të specialistëve të fushës, të ofrojë vlerë të shtuar në plotësimin e nevojave aktuale dhe perspektivë të zhvillimit të tregut në sektorin publik dhe privat, duke aftësuar të diplomuarit në përdorimin efikas të teknologjive bashkëkohore të përkthimit. Qëllimi i programit të Studimit “Bachelor në Gjuhë-Letërsi Angleze dhe Teknologji Përkthimi” është krijimi i specialistëve me njohuri të mira të gjuhës dhe letërsisë angleze, si edhe të teknologjive të përkthimit, të përgatitur për studime profesionale në mësuesi, kërkimin shkencor në teknologji të përkthimit, si edhe me dëshirë për kualifikim të mëtejshëm.

Programi i studimit “Bachelor në Punë Sociale” është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 180 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Program studimi profesionale në ‘Agrobiznes’ me profile: Menaxhim i Fermës Bujqësore dhe Marketing i Produktit Bujqësor: është program me karakter profesional që realizohet me 120 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 2-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Ky program studimi i takon nivelit të 5-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Profesionale në Agrobiznes me profil Menaxhim i Fermës Bujqësore” dhe “Diplomë Profesionale në Agrobiznes me profil Marketing i Produktit Bujqësor”. Ky program u hap në kuadrin e kërkesës në treg për specialistë të profilit agrobiznes, duke patur parasysh që agrobiznesi është perspektiva bazë e zhvillimit ekonomik në vendet në zhvillim sic është dhe vendi ynë. Ndjekja e studimeve në këtë program synon tu japë studentëve kualifikim e nevojshëm dhe një mundësi më shumë për të gjetur veten të përfshirë në sipërmarrjen dhe menaxhimin e aktiviteteve të agrobiznesit. Programi është në proces akreditimi.

Programi i Ciklit të Dytë të studimit “Master Profesional” në Financë Kontabilitet është program me kohë të plotë, i referohet nivelit 7 (shtatë) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohet me 60 kredite ECTS dhe kohëzgjatja normale e tij është 1 (një) vit akademik.

Programi i Ciklit të Dytë të studimit “Master Profesional” në Financë Kontabilitet i pajis të diplomuarit me njohuri të thelluara profesionale në fushën e Financës dhe Kontabilitetit duke reflektuar dinamikën e zhvillimeve në disiplinat përbërëse të kurrikollegji Universitar “LOGOS”ës si dhe specifikat e kërkesës së tregut dhe të ekonomisë shqiptare.

Studimet e Ciklit të Dytë, “Master Profesional” në Financë Kontabilitet, përmbyllen me provim përfundimtar ose punim diplome dhe në përfundim të tij, lëshohet diploma “Master Profesional” në Financë-Kontabilitet.

Programi i studimit “Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë” është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 60 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 1-vjeçare. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”.

Misioni i programit të studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është t’u japë studentëve që zotërojnë diplomë universitare Bachelor njohuri të thelluara teorike dhe praktike si dhe përgatitje të mirëfilltë profesionale nëpërmjet ushtrimit dhe zhvillimit të praktikave profesionale. Zgjerimi i njohurive të fituara në ciklin e parë të studimeve, i pajis studentët me kompetence të përgjithshme dhe profesionale në fushën e laboratorëve mjekësorë duke i bërë konkurrentë në tregun e punës në sektorët publikë e privatë. Programi ofron njohje më të plotë të aspekteve të ndryshme të mjekësisë laboratorike.

Objektivat e programit Master Profesional janë të qarta profesionalisht dhe të arritshme. Planet dhe programet mësimore janë në përputhje të plotë me kërkesat dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë si dhe kërkesat e sistemit të Bolonjës. Staf i akademik i programit të studimit Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë është nga me të kualifikuarit dhe me kompetencë të plotë shkencore dhe profesionale duke përmbushur maksimalisht kërkesat e programit mësimorë.

Programi i studimit Master Profesional në “Theologji Sociale dhe Praktike”

Misioni i programit Master Profesional “Theologjia Sociale dhe Praktike” është: ndikimi pozitiv i religjionit dhe thelogjisë sociale në nxjerrjen në pah të vlerave të nevojshme për zhvillimin dhe përparimin paqësor të shoqërisë; kuptimi më i plotë i diversiteteve, moralit dhe sjelljes që diktojnë respektin e njerëzve që u përkasin komuniteteve të ndryshme fetare të Shqipërisë; njohja e parimeve morale të Krishterimit dhe Islamit, si edhe të marrëdhënieve diakronike dhe moderne ndërmjet tyre në Evropën Juglindore është e vlefshme për gjithë ata njerëz që bashkëpunojnë në nivel të përditshëm dhe shoqëror në shërbime të ndryshme me qytetarët që i përkasin këtyre traditave fetare; Kultivimi i një fryme paqësore mirëkuptimi, duke luftuar fanatizmin, fundamentalizmin dhe shfrytëzimin e feve për qëllime egoiste në dëm të besimtarëve të të gjitha komuniteteve fetare; Kultivimi dhe trajnimi për ofrimin dhe formimin e kontekstit për dhënien e ndihmës në nivele të ndryshme ndaj njerëzve nga komunitete të ndryshme fetare, të cilët kanë nevojë për përforsim, mirëkuptim dhe mbështetje. Objektivat e programit janë: T'u japë pjesëmarrësve aftësitë e nevojshme për kërkimin sociologjik dhe zbatimin praktik të vlerave të Theologjisë Sociale për të trajtuar dhe parandaluar çështjet me bashkëjetesën e komuniteteve fetare dhe paqen sociale; Të diplomuarit e programit të studimit Master Profesional “Theologjia Sociale dhe Praktike” do të kenë formim shkencor dhe profesional me njohuri të avancuara në këtë fushë; Të diplomuarit do të kenë njohuri të mjaftueshme për traditat fetare që gjenden në Shqipëri; Të diplomuarit do të kultivojnë aftësitë e vetëdijes për të kuptuar dhe zgjidhur çështjet sociale që ndikojnë negativisht në grupet e dobëta sociale; Të diplomuarit do të familjarizohen me çështjet bashkëkohore të Etikës dhe të Bioetikës që mundojnë shoqërinë moderne dhe do të kuptojnë parimet bazë për trajtimin e tyre; Objektivi i Kolegjit Universitar “LOGOS” është të aftësojë studentët për të avancuar me studime në nivel doktorature dhe t'i nxisë ata të bëhen pjesë e mjediseve akademike.

Programi i studimit Master Shkencor “Turizëm Religjioz”

Programi i studimit Master i Shkencave në “Turizmin Religjioz” është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 120 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2-vite akademike. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe dhe angleze. Ky program studimi i takon nivelit të 7-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Master i Shkencave në Turizmin

Religjioz”. Misioni i programit është të ofrojë studime të thelluara për të gjithë studentët në fushën e zgjedhur, t’i përgatisë si ekspertë turizmi të aftë të marrin përsipër promocionin, marketimin, menaxhimin e destinacioneve të trashëgimisë kulturore e religjioze, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të drejtojnë në administratë publike qendrore dhe lokale, të themelojnë e menaxhojnë sipërmarrje turistike, si edhe të aftësohen për të kryer punë kërkimore për qëllime të avancimit në fushën specifike të njohurive.

Programi i studimit Master Shkencor në Përkthim Profesional

Programi i studimit Master i Shkencave në “*Përkthim Profesional*” është program i ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 120 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2-vite akademike. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe, greke dhe angleze.

Nga analiza e veprimtarisë së fakulteteve në fushën e kurrikulave, rezulton se tipari i përgjithshëm i veprimtarisë së Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor dhe Fakultetit të Shkencave të Aplikuara ka qenë konsolidimi i programeve që ofrojnë duke u përqendruar në përmirësimin e kurrikulave dhe të programeve mësimore të lëndëve si dhe pasurimi i ofertës akademike me programe të reja studimi, gjatë vitit 2023-2024.

Ofrimi i programeve cilësore të studimit është një nga synimet kryesore të Kolegjit Universitar “LOGOS”. Në këtë kuadër, për vitin akademik 2023-2024, u zbatua një proces i cili realizoi si normalisht disa përmirësime të syllabus të programeve të studimit si edhe përmirësime brenda masës 20% nisur edhe nga rekomandimet e ekspertëve apo sugjerimet e studentëve. Qëllimi i këtyre përmirësimeve ishte sigurimi i përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë të programeve të studimit si edhe nevojave që sjellin zhvillimet e tregut.

Përmirësimet e ndërmarra sollën një vlerë të shtuar të pasqyruar në:

- vendosjen e balancës më të mirë sipas përqindjeve të kërkuara për lëndët sipas kategorive;
- adresimin e rekomandimeve të dhëna nga ekspertët vlerësues dhe vendimet e bordit të ASCAL;

- përmirësimin e programeve mësimore të lëndëve sipas zhvillimeve të kohës me tendencë drejt aplikimit, inovacionit, digjitalizimit, AI dhe shkencës së hapur.

Gjatë vitit akademik 2023-2024, Kolegji Universitar “LOGOS” përgatiti paketën me disa programe të reja studimi dhe i paraqiti në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Aplikimi për këto programe u bë me synimin që të zgjerohej oferta akademike dhe të rritej numri i studentëve. Prej tyre u arrit marrja e miratimit për programin e studimit Master i Shkencave në “Financë Kontabilitet” i cili u hap për aplikantët në vitin akademik 2024-2025.

Konsolidimi i programeve ekzistuese dhe ofrimi i programeve të reja do të jetë në fokus për vitin e ardhshëm akademik. Programet e reja që do të studjohen me kujdes në përputhje me kuadrin kornizë të profesioneve, do të synojnë përmbushjen sa më të mirë të binomit ofertë-treg. Pasurimi i ofertës akademike me programe të reja do të orientohet drejt programeve të ciklit të dytë dhe njohjen e programeve të tij nga universitete të huaja partnere. Mendohet se në këtë mënyrë do të mundësohet plotësimi objektivave në funksion të misionit të Fondacionit LOGOS, mund të rritet numri i studentëve në Kolegjin Universitar LOGOS, të mundësohet ecja drejt ndryshimit të statusit të Kolegjit dhe të mundësohet një qasje me kosto më efektive për zhvillimin e qëndrueshëm të KOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS” si pjesë e sistemit të edukimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

TABELA 8: PROGRAMET E STUDIMIT

PROGRAMET E STUDIMIT 2023-2024						
FAKOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”TETI EKONOMIK						
Nr.	Programi i studimit	Kredite	Leja për hapjen	Statusi	Vendimi i akreditimit dhe riakreditimit	Vlefshmëria e akreditimit
1	Bachelor në Financë-Kontabilitet	180	Urdhër nr.1, datë 06.01.2011	Aktiv	Vendim nr.71, datë 04.10.2019 Urdhër nr.282, datë 04.07.2012	30.09.2024 03.07.2018
2	Bachelor në Menaxhim Biznesi	180	Urdhër nr.1, datë 06.01.2011	Aktiv	Vendim nr. 70, datë 15.03.2024 Urdhër nr.282, datë 04.07.2012	14.03.2030 15.03.2024
3	Bachelor në Menaxhim Turizmi	180	Urdhër nr.396, datë 02.08.2010	Aktiv	Vendim nr.179, datë 25.11.2023 Urdhër nr. 282, datë 04.07.2012	24.11.2027 25.11.2023
4	Master Profesional në Financë- Kontabilitet	60	Urdhër nr.428, datë 22.09.2017 Urdhër nr.335, datë 16.08.2013	Aktiv	Vendim nr.50, datë 13.07.2018	30.09.2023
5	Profesional 2 vjeçar Agrobiznes me profile	120	Urdhër nr. 405 datë 25.07.2019	Aktiv	Vendim nr. 38 dt. 22.04.2022	21/04/2025
FAKOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”TETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA						
Nr.	Programi i studimit	Kredite	Leja për hapjen	Statusi	Vendimi i akreditimit	Vlefshmëria e akreditimit
6	Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë	180	Urdhër nr.1, datë 06.01.2011	Aktiv	Vendim nr.178, datë 25.11.2023 Urdhër nr.282, datë 04.07.2012	24.11.2028 25.11.2023
7	Bachelor në Informatikë e Zbatuar	180	Urdhër nr.396, datë 02.08.2010	Aktiv	Vendim nr.221, datë 15.12.2023 Urdhër nr.282, datë 04.07.2012	14.12.2028 15.12.2023
8	Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë	60	Urdhër nr.428, datë 22.09.2017 Urdhër nr.335, datë 16.08.2013	Aktiv	Vendim nr.49, datë 13.07.2018	30.09.2023 A3.07.2018
FAKOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”TETI I SHKENCAVE HUMANE DHE KOMUNIKIMIT GJUHËSOR						
Nr.	Programi i studimit	Kredite	Leja për hapjen	Statusi	Vendimi i akreditimit	Vlefshmëria e akreditimit
9	Bachelor në Studime në Theologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze	180	Urdhër nr.192, datë 20.04.2018	Aktiv	Vendim BA Nr. 84, datë 04.11.2022	03.11.2026

10	Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek	180	Urdhër 433, datë 20.07.2018	Aktiv	Vendim BA Nr. 69, 10.09.2022	09.09.2026
11	Bachelor në Mësuesi në Arsimin Parashkollor	180	Urdhër nr. 432, datë 20.07.2018	Aktiv	Vendim BA Nr. 85, 04.11.2022	03.11.2026
12	Bachelor në “Punë Sociale”	180	Urdhër MAS Nr. 455, datë 26.07.2022	Aktiv	Nuk ka ende	Nuk ka ende
13	Bachelor në “Gjuhë-Letërsi Angleze dhe Teknologji Përkthimi”	180	Urdhër MAS Nr. 333 dt 4.7.2023	Aktiv	Nuk ka ende	Nuk ka ende
14	Master Profeional në “Theologji Sociale dhe Praktike”	60	Urdhër MAS Nr. 455 dt 14.08.2023	Aktiv	Në proces	Nuk ka ende
15	Master i Shkencave në “Turizmin Religjioz”	120	Urdhër MAS Nr. 374, datë 23.09.2021	Aktiv	Në process	Nuk ka ende
16	Master i Shkencave në “Përkthim Profesional”	120	Urdhër MAS Nr. 596, datë 04.10.2022	Aktiv	Në process	Nuk ka ende

e) NDRYSHIMET NË BAZËN RREGULLATORE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR LOGOS”

Gjatë vitit akademik 2023-2024, Kolegji Universitar “LOGOS”, për shkak të zhvillimit dinamik dhe ndjekjes së mbarëvajtjes së proceseve akademike dhe administrative ka miratuar disa dokumente rregullatore që lidhen me progresin e njësive bazë, ofrimin e programeve të reja të studimit, aktivitetit të studentëve në kolegji si dhe zhvillimit të procesit mësimor, duke zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

TABELA 9: NDRYSHIME NË DOKUMENTET RREGULLATORE TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “LOGOS

Gjatë vitit akademik 2023-2024, Kolegji Universitar “LOGOS” me vizionin e përmirësimit të vazhdueshëm, ka patur zhvillime sa i takon aplikimit për hapje të programeve të reja të studimit, për të cilat janë miratuar bazat rregullative përkatëse *si edhe adresimit të rekomandimeve të dhëna në kuadër të akreditimit të programeve të studimit*. Gjithashtu, pas kontrollit të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve bazuar në Urdhër nr.691 datë 16.11.2022 “Për realizimin e kontrollit të pajtueshmërisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë, me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi”, nëngrupi i punës krijuar me urdhër nr. 727 datë 07.12.2022 dërgoi raportin me gjetjet dhe rekomandimet. Me shkresën nr. 4124/6 datë 31.07.2024 Kolegji Universitar “LOGOS” u njoh me raportin e grupit dhe raportoi në MAS me shkresën nr.108/3 datë 12.08.2024 mbi marrjen e masave

për rishikimin e dokumentacionit rregullator, mbi bazën e të cilave institucioni ushtron aktivitetin, si dhe mbi plan adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të lëna në raport.

Nr.	Emërtimi i dokumentit	Organi i miratimit	Numri i dokumentit	Data e miratimit	Statusi i dokument
1	Miratimin e Statutit të ri të Kolegjit Universitar “LOGOS”	Senati Akademik	Nr.3 Nr.16	15.03.2023 21.07.2023	Ekzistues Ekzistues
2	Miratimin e rregullores së programit të studimit bachelor ne “Gjuhë dhe Civilizim Grek”.	Senati Akademik	Nr.10/1	05.07.2024	Ripunuar
3	Miratimin e protokolleve të Mobiliteteve Ndërkombëtare	Senati Akademik	Nr. 19	15.10.2024	I ri
4	Miratimin e Rregullores se Qendrës së Mësimdhënies dhe Nxënies	Senati Akademik	Nr. 20	15.10.2024	I ri
5	Miratimi i Rregullores së Përgjithshme të Kolegjit Universitar “Logos”	Senati Akademik	Nr.24	16.12.2024	Ripunuar
6	Miratimi i Rregullores së Senatit Akademik të Kolegjit Universitar “Logos”	Senati Akademik	Nr.25	16.12.2024	Ripunuar
7	Miratimi i rregullores së Veprimtarisë së Këshillit të Etikës	Senati Akademik	Nr.26	16.12.2024	Ripunuar
	Udhëzime				

INFORMACION PËR VEPRIMTARINË E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Kolegji Universitar “LOGOS” në zbatim të parimeve të përgjegjshmërisë dhe të transparencës ka ngritur një strukturë në nivel institucioni, e emërtuar Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni është një strukturë ndihmës-akademike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Kjo njësi bashkëpunon me Komisionin e Sigurimit të Cilësisë dhe është në varësi të Rektorit të Kolegji Universitar “LOGOS”.

Kjo njësi ka si mision të planifikojë, të drejtojë, të organizojë dhe të publikojë veprimtarinë e kryer në kuadrin e sigurimit të cilësisë në nivel institucioni dhe programesh studimi. Kjo njësi luan një rol të rëndësishëm në krijimin e kulturës së cilësisë që ndikon të arrijë dhe të ruajë një cilësi të lartë të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe shërbyese të KU “LOGOS”.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka vlerësuar, periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Për vitin akademik 2023-2024, para sezonit të provimeve finale për çdo semestër janë organizuar vlerësimet e studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me Zyrën për Çështjet e Studentore dhe Karrierës ka kryer studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji Universitar “LOGOS”. Këto të dhëna mund ti gjeni në rubrikën përkatëse të këtij raporti.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë gjatë vitit akademik 2023-2024 ka përgatitur raporte për vlerësimin e mësimdhënies së pedagogëve nga studentët dhe rezultatet e tyre përmes përgjegjësve të departamenteve respektive ju’a kanë përcjellë individualisht pedagogëve, duke u përdorë si burim për përmirësimin e cilësisë.

Gjithashtu, bazuar në Nenin 16, pika 3/1 të Rregullores së Sigurimit të Cilësisë, NJSBC i KU “LOGOS” ka organizuar veprimtari periodike me personelin dhe studentët e Kolegjit Universitar

“LOGOS” për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit, nëpërmjet:

- ✓ Zhvillimit të seancave të informimit të studentëve mbi rëndësinë e zhvillimit të pyetësorëve të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, treguesit e përdorur e mënyra e interpretimit të tyre;
- ✓ Trajnimit të stafit të ri akademik të përfshirë në strukturat e sigurimit të cilësisë për përfitimin e përvojës në këtë drejtim me qëllim krijimin e kulturës së cilësisë gjithmonë e më të gjerë në institucion.
- ✓ *Në përmbushje të përgjegjësisë së saj të cilësuar në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë, Neni 16, pika 3/h & i, NJSBC në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, ka organizuar vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies nga studentët dhe në fund të vitit akademik, ka organizuar vlerësimin për cilësinë e veprimtarisë së njësive bazë dhe të shërbimeve për studentët duke përdorur paketën e instrumenteve për vlerësimin e cilësisë të miratuar nga Senati Akademik i Kolegjit Universitar “LOGOS” bazuar në manualin e Cilësisë (sipas Kreut IV/Procedura të sigurimit të cilësisë, Neni 24/Inicimi i vlerësimit).*

Gjatë vitit akademik 2023-2024, NJSBC në zbatim të Nenit 27 të Rregullores/Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të monitorimit, vlerësimit dhe akreditimit, ka mbikëqyrur procesin për komunikimin dhe publikimin e vlerësimit, me qëllim garantimin e informimit në lidhje me sigurimin e cilësisë për të qenë i përshtatshëm, i arritshëm e i besueshëm duke hartuar raporte semestrale adresuar Rektorit të Kolegjit Universitar “Logos” dhe gjithashtu Kryetarit të Komisionit të Përhershëm të Garantimit të Standardeve të Cilësisë dhe drejtuesve të njësive kryesore e bazë në të cilat pasqyrohet qartë metodologjia e vlerësimit, matësit e përdorur, rezultatet e pritshme e interpretimi i tyre dhe sigurisht rezultatet e vlerësimit.

Proces vlerësimit bëhet çdo semestër në javën e parafundit të tij, para sezonit të provimeve. Proces monitorohet vazhdimisht për nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve në këtë proces. Për këtë qëllim, është kryer një komunikim i drejtpërdrejtë me studentët për të evidentuar problematika të mundëshme.

f) INFORMACION PËR ANGAZHIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

Kolegji Universitar “LOGOS” ka personel akademik, i cili është përmirësuar cilësisht gjatë vitit akademik 2023-2024. Trupa akademike e angazhuar gjatë vitit akademike 2023-2024 ka këto karakteristika kryesore.

Pedagogë me kontribute të spikatura. Në Kolegji Universitar “LOGOS” japin mësim pedagogë me formim nga një spektër i gjerë fushash studimi, të njohur për kontribute në mësimdhënie në arsimin e lartë, në kërkimin shkencor dhe zhvillimin e shoqërisë shqiptare.

Pedagogë me ekspertizë. Kolegji Universitar “LOGOS” ka pedagogë me përvoja nga bota reale. Mbi 70% e tyre sjellin përvojën e gjatë dhe të pasur nga shëndetësia, biznesi, informatika, administrata publike, arsimi, organizata dhe kompani të ndryshme. Ata e ndërthurin teorinë me shembujt e përvojës nga bota reale dhe lidhjet e tyre mund t’u sigurojnë studentëve mundësi të vlefshme për profesionin dhe rrjetet profesionale.

Pedagogë me formim dhe përvojë që përputhet me fushën e programit dhe lëndët mësimore. Personeli akademik dhe ndihmësakademik, që mbulon programin e studimit ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. Ky është një tregues që u përmirësua gjatë vitit akademik 2023-2024, duke pajtuar pedagogë, formimi dhe përvoja e të cilëve përputhen mirë me lëndët mësimore të programit të studimit, me kërkesat për veprimtaritë laboratorike dhe drejtimin e praktikës profesionale.

Mësimdhënie e nivelit të lartë. Pedagogët e Kolegjit Universitar “LOGOS” tregojnë një përkushtim të veçantë për të organizuar të nxënit e studentëve, bazuar në qasjen me në qendër studentin. Njohuritë, përvoja dhe përkushtimi i personelit akademik, të kombinuara me punën e studentëve, mbështesin zhvillimin e tyre si në aspektin akademik ashtu edhe personal. Kjo i ndihmon studentët që të jenë gati për fitimin e diplomës dhe vazhdimin e studimeve të mëtejshme ose të futen në botën e punës.

Raporti studentë-pedagog. Me një raport studentë – pedagog në Kolegjin Universitar “LOGOS” 2:1, studentët njohin personalisht pedagogët. Pedagogët nuk janë vetëm mësimdhënës, por janë, gjithashtu, këshilltarë dhe mentorë të besuar. Ata madje mund të ndihmojnë studentët të kryejnë projektin kërkimor - një mundësi kjo që nuk ofrohet kudo për studentët universitar. Studentët marrin vëmendjen që u nevojitet për të arritur sukses në shkallën më të lartë.

Personel ndërkombëtar. Kolegji Universitar “LOGOS” ka personel akademik ndërkombëtar që ofron një ekspertizë ndërkombëtare në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor. Të studiosh me pedagogë cilësorë, të përfitosh nga përvoja e pedagogëve me karrierë të gjatë në mësimdhënie, kërkime dhe me kontribut social, të mësosh gjuhë të huaja nga folës të gjuhës amtare është garanci për cilësinë e studimeve. Gjatë vitit akademik 2023-2024, Kolegji Universitar “LOGOS” ka personel akademik me kohë plotë që ka kryer së paku një cikël studimesh në universitete ndërkombëtare janë rreth 30 % dhe personel akademik me kohë të pjesshme janë rreth 45%.



TABELA 10: PERSONELI AKADEMIK

FONDACIONI LOGOS

KOLEGJI UNIVERSITAR "LOGOS"

Personeli akademik i Kolegjit Universitar "LOGOS" për vitin akademik 2023-2024

FAKOLEGJI UNIVERSITAR "LOGOS" TETI EKONOMIK

Departamenti Financë-Kontabilitet

Personeli akademik me kohë të plotë

Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Artur Ribaj	Prof.Dr.	Dekan/ Profesor
2	Romina Radonshiqi	PhD.	Drejtues Departamenti
3	Jehona Germizi	Dr.	Lektor
4	Elvis Xhori	MSc.Dr. Kandidat	Asistent lektor
5	Iva Sulaj	MSc.Dr. Kandidat	Asistent lektor

Personeli akademik me kohë të pjesshme

Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Petra Milo	Prof. Dr.	Profesor
2	Lindita Lati	Prof. Dr.	Profesor
3	Albana Gjoni	Prof. Asoc. Dr.	Profesor
4	Jona Mulliri	Prof. Asoc. Dr.	Profesor
5	Anila Bani	Dr.	Lektor
6	Ermal Haxhia	Dr.	Lektor
7	Lindita Varesi	Dr.	Lektor
8	Emiljano Mustaqe	Dr.	Lektor
9	Joniada Bajraba	Dr.	Lektor
10	Klejda Gabeshi	Dr. kandidat	Asistent lektor
11	Gerta Marko	MSc	Asitent lektor

Departamenti i Menaxhimit

Personeli akademik me kohë të plotë

Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Emira Spahaj	Dr.	Drejtues departamenti/ Lektor
2	Blerta Avdia	Dr.	Lektor
3	Anisa Balla	MSc.Dr. Kandidat	Asistent lektor
4	Entela Kostrista	MSc.Dr. Kandidat	Asistent lektor
5	Arjana Avdulaj	MSc	Asitent lektor

Personeli akademik me kohë të pjesshme

Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Etleva Muça	Prof. Dr.	Profesor

2	Elton Noti	Prof. Asoc. Dr.	Profesor
3	Marjana Nikolla	Prof. Asoc. Dr.	Profesor
4	Brunilda Baraku	Dr.	Lektor
5	Adriana Nika	Msc.	Asistent lektor
6	Fjorald Bitri	Msc.	Asistent lektor
7	Edmond Alija	Msc.	Asistent lektor
Departamenti i Agrobiznesit			
Personeli akademik me kohë të plotë			
Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Ledia Sula	Dr.	Drejtues departamenti/ Lektor
2	Olda Çiço	Dr.	Lektor
3	Enxhi Marku	MSc	Asistent lektor
4	Donika Nano	MSc	Asistent lektor
5	Eva Dautaj	Msc.	Asistent lektor
Personeli akademik me kohë të pjesshme			
Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Gjergji Papa	Prof. Asoc.Dr.	Profesor
FAKOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”TETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA			
Departamenti i Shkencave Mjekësore			
Personeli akademik me kohë të plotë			
Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Ridvana Mediu	Prof. Asoc. Dr.	Drejtues departamenti/ Profesor
2	Tefta Rota	Prof. Asoc. Dr.	Profesor
3	Erjona Abazaj	Prof. Asoc. Dr.	Profesor
4	Stela Nuri	MSc. SPA	Asistent lektor
5	Sokrat Rizo	MSc. SPA	Asistent lektor
6	Kristjana Nasto	MP.	Personel ndihmës akademik
7	Anisa Stefani	BSc.	Personel ndihmës akademik
Personeli akademik me kohë të pjesshme			
Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Shpëtim Qyra	Prof. Dr.	Profesor
2	Alma Barbullushi	Prof. Asoc. Dr.	Profesor
3	Oltiana Petri	Prof. Asoc. Dr.	Lektor
4	Daniela Xhemalaj	Dr.	Lektor

5	Margarita Kurti	Dr.	Lektor
6	Aurora Xhixha	Dr.	Lektor
7	Mikaela Kolasi	Dr.	Asistent lektor
8	Dashnor Fiska	Msc.	Asistent lektor
Departamenti i Shkencave te Shendetit dhe Mireqenies Sociale			
Personeli akademik me kohë të plotë			
Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/Kategoria
1	Spartak Bozo	Prof. Asoc. Dr.	Dekan/Profesor
2	Mersin Mersinllari	Prof. Dr.	Drejtues Departamenti/ Profesor
3	Gojard Cerga	Prof. Dr.	Profesor
4	Stelijan Buzo	Dr.	Lektor
5	Dorina Minxuri	Dr. SPA	Lektor
Departamenti Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës			
Personeli akademik me kohë të plotë			
Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Ilia Ninka	Prof.Dr.	Rektor / Profesor
2	Esmeralda Kadëna	PhD.	Drejtues Departamenti/ Lektor
3	Xhezmiye Palushi	Dr. Kandidat	Asistent lektor
4	Olta Petritaj	PhD.Dr. Kandidat	Asistent lektor
5	Eleni Papapano	MSc.	Asistent lektor
Personeli akademik me kohë të pjesshme			
Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Parashqevi Rrapo	Prof. Dr.	Profesor
2	Ana Ktona	Prof. Dr.	Profesor
3	Admir Barolli	Prof. Asoc. Dr.	Profesor
4	Silvana Greca	Dr.	Lektor
5	Robert Shagla	MSc.	Asistent lektor
6	Denada Rada	MSc.	Asistent lektor
7	Enxhi Mete	MSc.	Asistent lektor
Fakolegji Universitar “LOGOS”teti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor			
Departamenti i Theologjise dhe Kolegji Universitar “LOGOS”turës			
Personeli akademik me kohë të plotë			
Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Georgios Gaitanos	PhD	Drejtues departamenti/ Lektor

2	Jeffery MacDonald	PhD	Lektor
3	Thoma Shkira	PhD	Lektor
4	Athanasios Chatzopoulos	PhD	Lektor
5	Stephanos Ritsi	PhD.	Lektor
6	Anila Dervishi	MSc. PhD kandidat	Asistent lektor
7	Thoma Çomëni	MSc	Asistent lektor
Personeli akademik me kohë të pjesshme			
Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Klodiana Gorica	Prof. Dr.	Profesor
2	Esmeralda Agolli	Prof.Asoc. Dr.	Profesor
3	Edmond Kadiu	Prof.Asoc. Dr.	Profesor
4	Elio Hobdari	Dr.	Lektor
5	Edvaldo Begotaraj	Dr.	Lektor
6	Thomai Chovarda	PhD.	Lektor
7	Nikolaos Tsirevelos	PhD.	Lektor
8	Stephanos Athanasiou	PhD.	Lektor
9	Georgia Sarikoudi	PhD.	Lektor
10	Porfyrios Ntalianis	PhD	Lektor
11	George Keselopoulos	PhD	Lektor
12	Job Getcha (Bishop of Pisidias)	PhD	Lektor
13	Blerta Baba	MSc.	Asistent lektor
14	Emanuel Lusha	MSc.	Asistent lektor
15	Theo Kostoli	MSc.	Asistent lektor
16	Xhilian Spahiu	MSc.	Asistent lektor
Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek			
Personeli akademik me kohë të plotë			
Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Vasiliki Apostolouda	PhD	Drejtues departamenti/ Lektor
2	Anna Anastasiadi-Symeonides	Prof. Dr	Profesor
3	Marsela Harizaj	Prof. Asoc.Dr.	Profesor
4	Nikolaos Mathioudakis	Dr.	Lektor
5	Stavro Dajo	PhD	Lektor
6	Angeliki Basoucou	MSc. PhD kandidat	Asistent lektor
7	Elona Zirek	MSc	Asistent lektor
8	Anxhela Laska	MSc	Asistent lektor
Personeli akademik me kohë të pjesshme			

Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Artur Jaupaj	Prof Asoc. Dr.	Profesor
2	Asimakis Filatouras	PhD.	Lektor
3	Adelais Ismirliadou	PhD.	Lektor
4	Maria Plastira Valkanou	PhD.	Lektor
5	Thomas Bardakis	PhD.	Lektor
6	Olympia Tsaknaki	PhD.	Lektor
7	Parthena Charalambidou	PhD.	Lektor
8	Elpida Loupaki	PhD.	Lektor
9	Doris Kyriazis	PhD.	Lektor
Departamenti i Pedagogjisë dhe i Psikologjisë			
Personeli akademik me kohë të plotë			
Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Konstantinos Giakoumis	Prof. Asoc. Dr.	Dekan / Profesor
2	Agim Muçaj	Prof. Asoc. Dr.	Drejtues Departamenti i komanduar/ Profesor
3	Erleta Mato	Prof. Dr.	Profesor
4	Edo Sherifi	Prof. Asoc. Dr.	Dekan / Profesor
5	Konstantinos Dovolis	PhD	Lektor
6	Valbona Nathanaili	Dr.	Lektor
7	Juna Muça	MSc. Dr. kandidat	Asistent lektor
8	Saimira Gjapi	MSc. PhD. kandidat	Asistent lektor
9	Marinela Pane	Msc.	Asistent lektor
Personeli akademik me kohë të pjesshme			
Nr.	Emri i pedagogut	Titulli akademik/ garda shkencore	Pozicioni/ Kategoria
1	Sotir Rrapo	Prof. Asoc. Dr.	Profesor
2	Pranvera Kamani	Prof. Asoc. Dr.	Profesor
3	Edlira Sina	Dr.	Lektor
4	Valbona Keçi	PhD.	Lektor
5	Plarent Anamali	PhD.	Lektor
6	Alfred Nini	Dr.	Lektor
7	Donila Pipa	PhD.	Lektor
8	Suada Hawa	MSc. Dr. kandidat	Asistent Lektor
9	Xhulia Musta	MSc. Dr. kandidat	Asistent Lektor
10	Marlind Pelushi	MSc. Dr. kandidat	Asistent Lektor
11	Sonila Kapidani	MSc.	Asistent Lektor

12	Agi Nano	MSc.	Asistent Lektor
13	Alma Mara	MSc.	Asistent Lektor
14	Anisa Duka	MSc.	Asistent Lektor

Cilësia e personelit akademik është përmirësuar me pajtimin e pedagogëve me grada shkencore dhe ekspertizë të dalluar në fushën e tyre respektive. Ky ishte një tregues për të arritur një pozicion më të mirë në treg dhe për të plotësuar standardet shtetërore të cilësisë.

Tabela që paraqitet më poshtë përmban të dhëna për personelin akademik sipas fakulteteve dhe departamenteve të grupuar sipas titujve dhe gradave, si dhe sipas kategorisë personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm. Gjithashtu, tabela e mëposhtme mundëson një krahasim gjinor të personelit akademik.

Duke analizuar strukturën e njësive bazë sipas kategorive, vërejmë se personeli akademik me kohë të plotë përbëhet nga 14 profesorë, 19 lektorë, 21 asistent lektorë; ndërsa personeli akademik me kohë të pjesshme përbëhet nga 20 profesorë, 33 lektorë dhe 20 asistent lektorë. Në total janë 34 profesorë, 52 lektorë dhe 41 asistent-lektorë (përveç dy personave me status ndihmës akademik me karakter mësues). Pra, personeli akademik me tituj dhe grada përbën rreth 70% krahasuar me personelin e kategorisë asistent lektor, që përbën rreth 30%. Ky është një tregues që ka mbetur në nivelet e vitit akademik të mëparshëm. Duke synuar një personel akademik cilësor duhet që të shtohet numri i pedagogëve me grada dhe tituj, veçanërisht për të përmirësuar raportin e pedagogëve të brendshëm me tituj dhe grada. Rreth 50% e personelit akademik me kohë të plotë i kategorisë asistent lektor janë regjistruar në ciklin e tretë të studimeve doktoraturë.

TABELA 11: TABELË PËRMBLEDHËSE E PERSONELIT AKADEMIK PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024

FAKOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”TETI EKONOMIK

Departamenti	Prof. Dr	Prof. Asoc .	Lektor	Asistent -lektor	F	M	P A E	Prof. Dr	Prof. Asoc .	Lektor	Asistent -lektor	F	M	P A K		Total
DFK	1	0	2	2	3	2	5	2	2	5	2	8	3	11		16
DM	0	0	2	3	5	0	5	1	2	1	3	4	3	7		12
AG	0	0	2	3	5	0	5	0	1	0	0	0	1	1		6
Total	1	0	6	8	13	2	15	3	5	6	5	12	7	19		34

FAKOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”TETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA

Departamenti	Prof. Dr	Prof. Asoc .	Lektor	Asistent -lektor	F	M	P A E	Prof. Dr	Prof. Asoc .Dr	Lektor	Asistent -lektor	F	M	P A K		Total
DSHM	0	3	0	2	4	1	5	1	2	4	1	6	2	8		13
DSHS HMS	2	1	2	0	1	4	5	0	0	0	0	0	0	0		5
DIZS	1	0	1	3	4	1	5	2	1	1	3	4	3	7		12
Total	3	4	3	5	9	6	15	3	3	5	4	10	5	15		30

FAKOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”TETI I SHKENCAVE HUMANE DHE KOMUNIKIMIT GJUHËSOR

Departamenti	Prof. Dr	Prof. Asoc .	Lektor	Asistent -lektor	F	M	P A E	Prof. Dr	Prof. Asoc .Dr	Lektor	Asistent -lektor	F	M	P A K		Total
DTHK	0	0	5	2	1	6	7	1	2	9	4	6	10	16		23
DGJCG	1	1	3	3	6	2	8	0	1	8	0	5	4	9		17
DPP	1	3	2	3	6	3	9	0	2	5	7	10	4	14		23
Total	2	4	10	8	13	11	24	1	5	22	11	21	18	39		63
Totale	6	8	19	21	35	19	54	7	13	33	20	43	30	73		127

g) TË DHËNA PËR GJURMIN E STUDENTVE QË KANË PËRFUNDUAR STUDIMET PËR SECILIN PROGRAM STUDIMI

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në bashkëpunim me Zyrën për Çështjet Studentore dhe Këshillimin e Karrierës, kryen studime të gjurmimit për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji Universitar “LOGOS”.

Një nga aspektet më të rëndësishme që Kolegji Universitar “LOGOS” ka në konsideratë është ndjekja dhe mbështetja e studentëve gjatë gjithë rrugëtimit të tyre, që nga momenti i shfaqjes së interesit për Kolegjin Universitar “LOGOS”, pas përfundimit të shkollës së mesme, gjatë studimeve të ciklit të parë dhe të dytë, dhe deri në fazën e zhvillimit të jetës profesionale. Ky proces realizohet përmes Zyrës për Çështjet Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, që krijon dhe menaxhon një rrjet mbështetjeje me studentët, duke organizuar takime të rregullta dhe duke përdorur mekanizma të ndryshëm për mbledhjen e informacionit të përditësuar.

Një nga këto mekanizma është formulari i ndërtuar posaçërisht për të mbledhur të dhëna mbi punësimin e studentëve, që mundëson një mbikëqyrje të vazhdueshme të ecurisë së tyre profesionale. Përmes këtij rrjeti, Kolegji Universitar “LOGOS” mbështet parimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe mbledh informacione dhe prova mbi kërkesat e tregut të punës. Kështu, departamentet përkatëse mund të organizojnë biseda, seminare, ose kurse trajnimi që i ofrohen studentëve, duke i trajtuar ata si kolegë.

Për më tepër, të dhënat për vitin akademik 2023-2024 janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

**TABELA 12: TË DHËNA PËR PUNËSIMIN E STUDENTËVE PËR VITIN
AKADEMIK 2023-2024 ²**

² Te dhenat e studenteve jane te perditesuar deri me tetor 2024

FAKULTETI EKONOMIK						
Nr.	Programi i studimit	Viti akademik	Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)	Të papunësuar ose vazhdim studimesh ³
1	BA në “Menaxhim Turizmi”	2023 -2024	4	3	1	2 (vazhdim studimesh)
2	BA në “Finance Kontabilitet”	2023 -2024	8	5	2	3 (vazhdim studimesh)
3	BA në “Menaxhim Biznesi”	2023 -2024	9	5	4	3 (vazhdim studimesh)
4	Program i studimit 2-vjeçar me karakter profesional në agrobiznes me profil “Marketing i Produktit Bujqësor”	2023 -2024	1	-	1	-
5	MP në “Financë Kontabilitet”	2023 -2024	13	11	2	4 (vazhdim studimesh)

FAKULTETI I SHKENCAVE TE APLIKUARA						
Nr.	Programi i studimit	Viti akademik	Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)	Të papunësuar ose vazhdim studimesh
1	BA në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësore ⁴	2023 -2024	35	15	12	18 (vazhdim studimesh)
2	BA në Informatikë e Zbatuar	2023 -2024	17	9	4	7 (vazhdim studimesh)

³ Këto janë rastet e studenteve të numëruar dy here që ndjekin një punë dhe vazhdojnë studimet.

⁴ Shënim: Që të punësohen studentët duhet të marrin licencën duke dhënë provim shtetëror.

3	MP në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë	2023 -2024	14	12	2	-
---	---	------------	----	----	---	---

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE KOMUNIKIMIT GJUHESOR						
Nr.	Programi i studimit	Viti akademik	Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)	Të papunësuar ose vazhdim studimesh
1	BA në Studime në Theologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze	2023 -2024	3	2	1	1 (vazhdim studimesh)
2	BA në Mësuesi për Arsimin Parashkollor	2023 -2024	5	4	1	1 (vazhdim studimesh)
3	BA në Gjuhë dhe Civilizim Grek	2023 -2024	1	-	1	-
4	Msc Turizëm Religjioz	2023 -2024	5	3	2	1 (vazhdim studimesh)
5	Msc Përkthim Profesional	2023 -2024	0	-	-	7 (vazhdim studimesh)
6	MP Theologji Sociale dhe Praktike	2023-2024	5	4	1	2 (vazhdim studimesh)

Të dhënat e tabelës së mësipërme tregojnë se studentët që përfundojnë ciklin e dytë të studimeve (master) kanë një nivel të lartë punësimi, afërsisht mbi 75% e tyre punësohen në përputhje me diplomën e tyre të studimit. Nga ana tjetër, studentët që përfundojnë ciklin e parë të studimeve, kryesisht janë të punësuar në pozita që nuk janë në përputhje me diplomën e tyre. Ky është një

faktor kryesor që i shtyn ata të vazhdojnë studimet në ciklin e dytë, me qëllim që të arrijnë një punësim më të përshtatshëm dhe në përputhje me fushën e diplomës së tyre.

Një tjetër faktor që ndikon në këtë trend është kërkesa e tregut të punës, i cili gjithnjë e më shumë kërkon të diplomuar nga programet e ciklit të dytë (master).

Për më tepër, shembujt e karrierës profesionale dhe mundësitë për vazhdimin e studimeve përdoren gjithashtu si informacion njohës për aplikantët potencial për Kolegjin Universitar "LOGOS". Referencat nga pedagogët dhe diploma e Kolegjit Universitar "LOGOS" janë një element i rëndësishëm në vlerësimin e aplikimeve të studentëve tanë, jo vetëm në nivel lokal, por edhe për mundësitë për aplikime në institucione dhe tregje pune ndërkombëtare.

h) TË DHËNAT PËR KËSHILLAT STUDENTORË DHE PËRFAQËSIMI I TYRE NË ORGANET DREJTUESE DHE NË NJËSINË E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Që nga viti 2019, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka implementuar vlerësimin studentor për veprimtarinë mësimore të departamenteve, një proces i rëndësishëm për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Ky vlerësim realizohet në fund të çdo semestri dhe para sesionit të provimeve, me qëllim vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për çdo lëndë dhe program studimi.

Në përputhje me këtë politikë, institucioni mbledh mendimet dhe vlerësimet e studentëve pas çdo semestri, duke u kërkuar atyre të plotësojnë dy formularë të standardizuar. Ky feedback është përdorur për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, programeve mësimore dhe aktiviteteve të departamenteve. Të gjitha fakultetet janë angazhuar aktivisht në përfshirjen e studentëve në veprimtaritë akademike, kërkimore dhe zhvilluese që organizohen nga këto departamente.

Në Kolegjin Universitar "LOGOS" vepron Shoqata e Alumnit, e cila përfshin anëtarët e diplomuar të Kolegjit, të cilët kontribuojnë me idetë dhe përvojën e tyre në përmirësimin e ofertës akademike

dhe promovimin e institucionit. Kjo shoqatë ka një rol të rëndësishëm në lidhjen e diplomuarve me institucionin dhe rritjen e ndikimit të Kolegjit në shoqëri.

Zyra e Çështjeve Studentore dhe Karrierës, në përputhje me misionin e Kolegjit për vitin akademik 2023-2024, ka pasur si prioritet mbështetje për pjesëmarrjen aktive të studentëve në aktivitete të ndryshme që kontribuojnë në realizimin e misionit institucional. Kjo Zyrë ka ofruar këshillim karriere për studentët dhe ka mbështetur veprimtaritë e Shoqatës së Alumnit. Për më tepër, Zyra ka organizuar pjesëmarrjen e studentëve në panairin e punës, ditët e hapura për maturantët dhe aktivitete sociale si dhurimi i gjakut dhe ndihma për ata që kanë nevojë, siç janë shtëpitë e fëmijëve dhe mense sociale etj. Po ashtu, Zyra e Çështjeve Studentore angazhohet në promovimin dhe mbështetje të aktiviteteve të klubet studentore brenda Kolegjit Universitar “LOGOS”.

Kolegji Universitar “LOGOS” inkurajon studentët të jenë pjesë aktive e organizimit dhe menaxhimit brenda institucionit. Studentët janë të përfshirë në organet kolegjiale, të cilat përfshijnë:

- Senatin Akademik;
- Këshillin e Etikës;
- Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë;
- Komisionin e Përhershëm të Marrëdhënieve me Studentët.

Në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Këshillit Studentor, Kolegji mbështet krijimin dhe zhvillimin e organizmave studentorë, të cilët janë rezultat i zgjedhjeve të zhvilluara nga vetë studentët. Aktivitetet e këtyre organizmave monitorohen dhe mbështeten nga Zyra e Çështjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës. Këshillat studentore kanë rol të rëndësishëm në shprehjen e mendimeve dhe propozuar zgjidhje për çështje që kanë interes të përgjithshëm për institucionin.

Gjithashtu, kërkesat e studentëve për realizimin e aktiviteteve të ndryshme apo kërkesa për përmirësimin e shërbimeve, trajtohen me prioritet dhe në mënyrë të veçantë nga Kolegji Universitar “LOGOS”, duke siguruar një përkushtim të vazhdueshëm për përmirësimin e eksperiencës akademike dhe jetës studentore.

i) VLERËSIME DHE REKOMANDIME TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “LOGOS” PËR MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Kolegji Universitar «LOGOS» vlerëson se marrëdhënia me MAS ka qenë institucionale, korrekte dhe e frytshme.

Gjithashtu, vlerësojmë edhe marrëdhënien shumë profesionale me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë (ASCAL-in) si edhe me Qendrën e Shërbimit Arsimor (QSHA). Vlerësojmë se ASCAL ka bërë trajnime për stafin e Kolegji Universitar «LOGOS» me qëllim përgatitjen e tyre për shkrimin e raportit të vlerësimit të brendshëm për programet e studimit dhe përgatitjet për vlerësimin institucional.

Nisur edhe nga praktika e vitit të kaluar akademik, Kolegji Universitar «LOGOS» përcjell mesazhin se:

- a. Do të ishte ndihmuese që MAS të nxjerrë një vendim, udhëzim lidhur me përkufizimin e termit “student i shkëlqyer”.
- b. Do të ishte ndihmuese për të interesuarit për arsimin nëse do të amendohej Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” lidhur me format e studimit, duke shtuar studimet me kohë të pjesshme për ciklin e parë dhe studimin në distancë.

j) INFORMACION PËR STUDENTËT

Aspektet dhe problematikat që lidhen më numri i studentëve është një çështje shumë dimensionale, e cila kërkon jo vetëm analizën e statistikave, por njohjen e aspekteve demografike, ekonomike, sociale të popullsisë sikurse kërkohet një njohje dinamike e kërkesave të tregut të punës e ndërlidhur kryesisht me vizionin e zhvillimeve të ardhshme se sa me të tashmen.

Gjatë vitit akademik 2023-2024, në vitin e parë u regjistruan 103 studentë, ndërsa u diplomuan 120 studentë. Tabela 13 paraqet në mënyrë të strukturuar të gjitha të dhënat që lidhen me aspektet sasiore të studentëve sipas të gjitha programeve të studimit të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë që ofroi gjatë vitit akademik 2023-2024 Kolegji Universitar “LOGOS”. Më konkretisht, paraqiten të dhënat e detajuara për çdo fakultet të Kolegji Universitar “LOGOS”-it dhe sipas programeve të studimit:

- Numër i përgjithshëm i studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit;
- Numrin e studentëve të shkëlqyer
- Numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar
- Gjatë vitit akademik 2023-2024 janë trajtuar me bursa gjithsej 64 studentë, nga të cilët: 8 bursa mbështesë; 32 bursa ekselence dhe 24 bursa ekonomike.

TABELA 13: TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR STUDENTËT

TË DHËNA STATISTIKORE PËR STUDENTËT PËR VITIN
AKADEMIK 2023-2024

	Studentë të regjistruar				Studentë kalues	Studentë të diplomuar	Studentë të çregjistruar	Studentë të transferuar	Studentë të shkëlqyer
	Total	Viti I	Viti II	Viti III					
FAKOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”TETI EKONOMIK	68	29	15	24	50	35	2	6	1
BA në Financë-Kontabilitet	21	6	7	8	18	8	0	1	1
BA në Menaxhim Biznesi	21	7	4	10	19	9	2	2	0
BA në MenaxhimTurizmi	13	4	3	6	10	4	0	3	0
Profesional Agrobiznes	3	2	1	0	0	1	0	0	0
MP në Financë-Kontabilitet	10	10	0	0	10	13	0	0	0
FAKOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”TETI I SHKENCAVE TE APLIKUARA	135	47	34	54	127	66	0	4	3
BA në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësore	81	21	25	35	79	35	0	1	2
BA në Informatikë e Zbatuar	39	11	9	19	35	17	0	3	1
MP në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë	15	15	0	0	13	14	0	0	0
FAKOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”TETI I SHIKENCAVE HUMANE DHE KOMUNIKIMIT GJUHËSOR	56	27	23	6	52	19	0	0	3
BA në Studime në Theologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze	6	2	3	1	5	3	0	0	0
BA në Mësuesi për Arsimin Parashkollor	21	9	7	5	21	5	0	0	0
BA në Pune Sociale	10	5	5	0	10	0	0	0	1
BA në Gjuhë dhe Civilizim Grek	3	0	3	0	3	1	0	0	0
Msc Turizëm Religjioz	5	1	4	0	4	5	0	0	1
Msc Përkthim Profesional	6	5	1	0	4	0	0	0	0
MP Theologji Sociale dhe Praktike	5	5	0	0	5	5	0	0	1
TOTALI	259	103	72	84	229	120	2	10	7

Sikurse është prezantuar më parë Kolegji Universitar “LOGOS” i ka kushtuar vëmendje të veçantë bashkëpunimit me universitete të vendve të tjera me synimin e shkëmbimit të eksperiencave jo vetëm midis personelit akademik por kryesisht duke përsfërë edhe studentët.

Një karakteristikë tjetër shumë e rëndësishme që bashkëshoqëron analizën e punës akademike lidhet me cilësinë e mësim-nxënies. Tabela 14 paraqet të dhëna të detajuara mbi koeficientin e kalueshmërisë dhe të notës mesatare sipas të gjitha niveleve të programeve që përmban oferta akademike e Kolegjit Universitar “LOGOS” për vitin 2023-2024

TABELA 14: TË DHËNA PËR KALUESHMËRINË DHE NOTËN MESATARE TË STUDENTËVE PËR VITIN AKADEMIK 2023 – 2024

FAKULTETI EKONOMIK				
Nr.	Programi i studimit	Numri total i studentëve	Kalueshmëria ne total	Nota mesatare për numrin total të studentëve
1	BA në Financë-Kontabilitet	21	86%	7.48
2	BA në Menaxhim Biznesi	21	90%	7.06
3	BA në MenaxhimTurizmi	13	78%	7.2
4	Profesional Agrobiznes	3	100.00%	7.59
5	MP në Financë-Kontabilitet	10	100.00%	8.36
FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA				
Nr.	Programi i studimit	Numri total i studentëve	Kalueshmëria ne total	Nota mesatare për numrin total të studentëve
6	BA në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësore	81	98.00%	7.9
7	BA në Informatikë e Zbatuar	39	89.70%	7.5
8	MP në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë	15	87.00%	7.9
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE KOMUNIKIMIT GJUHËSOR				
Nr.	Programi i studimit	Numri total i studentëve	Kalueshmëria ne total	Nota mesatare për numrin total të studentëve
9	BA në Studime në Theologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze	6	83.00%	8.8
10	BA në Mësuesi për Arsimin Parashkollor	21	100%	8.69

11	BA në Pune Sociale	10	100%	8.8
12	BA në Gjuhë dhe Civilizim Grek	3	100.00%	8.1
13	Msc Turizëm Religjioz	5	80%	8.7
14	Msc Përkthim Profesional	6	67%	7.5
15	MP Theologji Sociale dhe Praktike	5	100%	9.35

Nisur nga analiza e të dhënave në tabelën 13 mbi regjistrimet në vitet e para për programet e studimit me kohë të plotë pranë Kolegji Universitar “LOGOS”, pavarësisht se edhe për këtë vit akademik kemi qëndrueshmëri dhe rritje të lehtë, mund të themi se numëri i ulët i studentëve të regjistruar në arsimin e lartë mbetet sfidë e vazhdueshme. Në përgjithësi ka një numër në rënie të kontigjentit të nxënësve që i drejtohen IAL-ve për shkakë të rënies natyrale si dhe të mesatares së aplikuar nga qeveria. Në përballimin e këtyre sfidave, alternativat për të cilat duhet të punojë Kolegji Universitar “LOGOS” konsistojnë: hapja e programeve të reja të studimit në master shkencor, si edhe e ndonjë programi të kërkuar nga tregu si ato të lidhura me dizajn, marketing, shëndetin e teknologjinë, si edhe tërheqja e studentëve ndërkombëtarë duke aplikuar strategji për ndërkombëtarizim dhe diversifikim të bazës së studentëve.

Nga analiza e të dhënave në tabelën 14 mbi rezultatet e kalueshmërisë dhe mesataren e notave për vitin akademik në vazhdim, vërehet rëndësia e cilësisë së mesatares së studentëve si një tregues kyç për standardin e arsimit. Megjithatë është përmirësuar cilësia e studentëve në hyrje për shkak të vendosjes së një mesatare minimale për pranimin në programet bachelor, studentët që zgjedhin programet e Fakultetit Ekonomik në Kolegjin Universitar “LOGOS” tregojnë një performancë të mirë, duke arritur të mbajnë mesataren e notës mbi 7. Ky rezultat është një reflektim i përpjekjeve të stafit akademik për të rritur cilësinë e përgatitjes dhe edukimit të profesionistëve, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive dhe njohurive që përmbushin kërkesat e tregut të punës.

Në një nivel më të lartë janë rezultatet e arritura nga studentët e programeve të shkencave të aplikuara dhe ato të shkencave humane dhe komunikimit gjuhësor, të cilët kanë arritur një mesatare që lëviz rreth notës 8, me një tendencë të qartë drejt notës 9. Ky përmirësim është një shenjë pozitive që tregon angazhimin e studentëve dhe cilësinë e mësimdhënies në këto programe, si dhe përkushtimin e stafit për të mbështetur studentët në zhvillimin e tyre akademik.

